

UNIVERSITETI I EJL

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ

SEE UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**VETËQEVERISJA LOKALE NË TË DREJTËN POZITIVE TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT DHE NË TË DREJTËN KOMPARATIVE**

Kandidati:

Senad Asani

Mentori:

Assoc. Prof. Dr.sc. Blerton Sinani

Tetovë, 2024

DEKLARATË

Unë, Senad Asani deklaroj dhe vërtetoj se unë jam autor origjinal i këtij punimi të magjistraturës me titull: “*Vetëqeverisja lokale në të drejtën pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në të drejtën komparative*” dhe se të gjitha referencat si dhe citimet e marra nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike janë të shënuara me fusnota në fund të çdo faqeje si dhe në fund të këtij punimi. Me këtë rast, poashtu deklaroj se Universitetit ia barti të gjithë të drejtat autoriale të këtij punimi, për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Senad Asani, Nr. ID. 128962

PËRMBAJTJA

ABSTRACT	6
QËLLIMI DHE RËNDËSIA E PUNIMIT	7
METODOLOGJIA HULUMTUESE.....	11
KAPITULLI I.....	12
SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME HYRËSE MBI VETËQEVERISJEN LOKALE.....	12
1.1 Në përgjithësi mbi zhvillimin historik të vetëqeverisjes lokale.....	12
1.2 Kahjet e zhvillimit të pushtetit lokal	16
1.3 Nocioni, rëndësia dhe karakteristikat themelore të pushtetit lokal.....	17
1.4. Pushteti lokal-decentralizmi dhe dekoncentrimi.....	20
1.5 Pushteti lokal dhe regjionalizmi	21
1.6 Pushteti lokal në disa shtete	22
KAPITULLI II.....	27
TEORITË (BOTËKUPTIMET) PËR VETËQEVERISJEN LOKALE.....	27
2.1 Teoria për të drejtat municipale.....	27
2.2 Shkolla historiko-juridike dhe vetëqeverisja lokale.....	27
2.3 Teoria e <i>self-government</i>	28
2.4 Teoria shtetërore e vetëqeverisjes lokale	29
2.5 Teoria normativiste dhe administrata lokale	29
2.6 Teoria e "qeverisjes lokale" <i>versus</i> "vetëqeverisja lokale".....	30
2.7 Teoria e <i>community development</i>	30
KAPITULLI III	32
ASPEKTE JURIDIKO-KOMPARATIVE MBI VETËQEVERISJEN LOKALE	32
3.1 Vetëqeverisja lokale në Gjermani	32
3.2 Vetëqeverisja lokale në Francë	34
3.3 Vetëqeverisja lokale në Britaninë e Madhe	36
3.4 Vetëqeverisja lokale në Poloni	38

3.5 Vetëqeverisja lokale në Danimarkë.....	40
KAPITULLI I IV	41
Vetëqeverisja lokale në të drejtën pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	42
4.1 Baza normative kushtetuese dhe ligjore e vetëqeverisjes lokale në RMV	42
4.2 Kryetari i Komunës	47
4.3 Këshilli i Komunës	49
4.4 Organizimi i administratës komunale.....	52
4.5 Mbikqyrja mbi punën e komunave	53
4.7 Mbikqyrja e ligjshmërisë të akteve normative juridike të komunës.....	56
4.8 Mbrojtja juridike kushtetuese e vetëqeverisjes lokale	56
4.9 Transparenca në punën e komunave në rafshin lokal.....	58
4.9.1 Zbatimi dhe promovimi i parimeve të transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunal.....	62
BIBLIOGRAFIA.....	69

ABSTRAKT

Ky punim i masterit shqyrton dhe trajton aspektet juridike kryesore e më të rëndësishme mbi konceptin juridik të vetëqeverisjes lokale në kontekstin e të drejtës nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke iu kushtuar vëmendje aspektit komparativo-juridik, vështrohen dhe shtjellohen disa nga modelet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit lokal në disa nga shtetet e caktuara me demokraci të zhvilluar: Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Polonia dhe Danimarka.

Vetëqeverisja lokale në të drejtën nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të përfshijë një analizë koncise të rolit të vetëqeverisjes lokale në sistemin juridik të Maqedonisë së Veriut, duke hedhur dritë mbi ndërveprimet midis autoriteteve lokale dhe qeverisjes qendrore, si dhe ndikimin e faktorëve historikë, kulturorë dhe politikë në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale.

Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është pjesë e sistemit të saj të qeverisjes politike. Ajo është rregulluar në rrafshin kushtetues dhe ligjor, duke u dhënë komunave si njësi administrative të vetëqeverisjes lokale kompetenca në fusha të caktuara juridike me vlerë e rëndësi lokale, siç janë arsimi, shëndetësia, infrastruktura lokale, zhvillimi ekonomik lokal etj.

Në kuadër të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, një pjesë e rëndësishme është ndarja e kompetencave midis niveleve të ndryshme të qeverisjes. Kjo përfshin transferimin me ligj të kompetencave dhe burimeve financiare të caktuara nga pushteti qendror shtetëror drejt njësive administrative të vetëqeverisjes lokale në kuadër të procesit të decentralizimit.

Organet e vetëqeverisjes lokale janë institucione, që gjenden më pranë qytetarëve dhe pa asnjë dyshim, vetëqeverisja lokale mund të konsiderohet si niveli më i afërt i pushtetit të qytetarëve për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror në rrafshin lokal dhe afirmimin e demokracisë lokale.

АПСТРАКТ

Овој магистерски труд ги испитува и обработува главните и најважните правни аспекти на локалната самоуправа во контекст на националното право на Република Северна Македонија. Обрнувајќи внимание на компаративно-правниот аспект, се разгледуваат и елаборираат некои од моделите на организација и функционирање на локалната власт во некои од земјите со развиена демократија: Германија, Велика Британија, Франција, Полска и Данска.

Локалната самоуправа во националното право на Република Северна Македонија опфаќа концизна анализа на улогата на локалната самоуправа во правниот систем на Северна Македонија, расветлувајќи ги интеракциите помеѓу локалните власти и централната власт, како и влијанието на историските, културните фактори и политиката во развојот на локалната самоуправа.

Локалната самоуправа во Република Северна Македонија е дел од нејзиниот систем на политичко управување. Тој е регулиран на уставно и законско рамниште, давајќи им на општините како административни единици на локалната самоуправа овластувања во одредени правни области од локална вредност и значење, како што се локални јавни услуги: образование, здравство, локална инфраструктура, локален економски развој итн.

Во рамките на локалната самоуправа во Република Северна Македонија, важен дел е поделбата на овластувањата помеѓу различни нивоа на управување. Овде спаѓа и преносот со закон на одредени овластувања и финансиски средства од централната државна власт на административните единици на локалната самоуправа во рамките на процесот на децентрализација.

Органите на локалната самоуправа се институции кои се поблиски до граѓаните и без никакво сомневање, локалната самоуправа може да се смета како најблиско ниво на власта до граѓаните за сеопфатен општествен развој на локално ниво и афирмација на локалната демократија.

ABSTRACT

This master's thesis provides an analysis of the legal aspects of local self-government within the national law of the Republic of North Macedonia, with a focus on the comparative-legal aspect of developed democratic States, including Germany, Great Britain, France, Poland, and Denmark. The thesis examines the role of local self-government in the legal system of North Macedonia, highlighting the interactions between local authorities and the central government, and the historical, cultural, and political factors that have influenced its development.

Local self-government in the Republic of North Macedonia is regulated at the constitutional and legal level, with municipalities having specific powers in areas such as education, health, local infrastructure, and economic development. Furthermore, the thesis emphasizes the importance of the decentralization process in transferring certain powers and financial resources from the central state power to the administrative units of local self-government.

The institutions of local self-government play a crucial role in comprehensive social development and the affirmation of local democracy. They are closer to citizens and provide an essential level of power for local value and importance. The division of powers between different levels of government is a crucial aspect of local self-government and ensures that power is distributed appropriately.

In conclusion, this thesis provides a comprehensive analysis of local self-government in the Republic of North Macedonia, highlighting the importance of legal regulation, the decentralization process, and the significance of the institutions of local self-government in promoting comprehensive social development and local democracy.

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E PUNIMIT

Organizimi dhe funksionimi i sistemit në nivelin e vetëqeverisjes lokale, është i rëndësishëm për çdo shtet, e në veçanti për shtetet me sistem bashkëkohor demokratik . Për një kohë të gjatë, por edhe aktualisht, kjo është fushë interesimi i shumë teoricientëve të ndryshëm, e në rend të parë për konsitucionalistët dhe politologët. Në pjesën më të madhe të shteteve dhe në teorinë shkencore, trajtimi i konceptit të vetëqeverisjes lokale është sinonim i autonomisë lokale, përkatësisht miko-qeverisjes politike në zona territoriale më të ngushta të kufizuara në kuadër të kufijve të territorit të një bashkësie shtetërore të caktuar. Garantimi formalo juridik me kushtetutë ose me ligj i vetëqeverisjes lokale është hapi i parë për zbatim të demokracisë lokale, që realizohet në ambient të mirë organizuar të vetëqeverisjes lokale, me qytetarë aktiv dhe pushtet përgjegjës.

Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga një numër i madh i komunave, secila me këshillat e saj komunal dhe një kryetar komune. Përmes votimit të qytetarëve, zgjidhen këshillat komunal dhe kryetarët e komunave, duke siguruar pjesëmarrje dhe përfaqësim të drejtpërdrejtë nga komunitetet në proceset vendimmarrëse. Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përfshin një gamë të gjerë të kompetencave për komunat si autoritete qeverisëse politike lokale: planifikimin urbanistik, administratën lokale, shërbimet sociale, arsimin, infrastrukturën, kulturën dhe sportin etj. Ky model i vetëqeverisjes thekson përkushtimin ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies së qytetarëve në nivele lokale.

Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjithashtu ka si synim ndërtimin e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e burimeve publike, duke siguruar që vendimet dhe veprimet lokale të reflektojnë nevojat dhe aspiratat e komunitetit. Përveç kësaj, ky model i vetëqeverisjes promovon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në hartimin e politikave dhe vendimeve që kanë ndikim direkt në jetën e tyre të përditshme. Për më tepër, qëllimi i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është të sigurojë administratë efikase dhe të afërt me qytetarët për menaxhimin e çështjeve lokale. Kjo përmirëson pjesëmarrjen civile dhe promovon zhvillimin lokal duke përshtatur nevojat e komuniteteve të ndryshme. Rëndësia e vetëqeverisjes lokale theksohet në decentralizimin e vendimmarrjes, duke lejuar zgjidhje më të përshtatshme për çështje specifike në nivel lokal.

Vetëqeverisja lokale ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në shërbimet publike, pasi qytetarët kanë akses më të drejtpërdrejtë dhe ndikim në vendimmarrjen. Kjo

gjithashtu kontribuon në promovimin e diversitetit etnik, kulturor dhe ekonomik, duke inkurajuar iniciativat lokale dhe zhvillimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë. Nëpërmjet vetëqeverisjes lokale, krijohet një mjedis ku autoritetet lokale janë më afër nevojave të komuniteteve dhe mundësojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në hartimin e politikave. Kjo ndikon në krijimin e një shoqërie më të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme në nivel lokal, duke thelluar lidhjen midis qytetarëve dhe institucioneve lokale. Vetëqeverisja lokale ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në shërbimet publike, pasi qytetarët kanë akses më të drejtpërdrejtë dhe ndikim në vendimmarrjen.

Një aspekt esencial, tipik dhe i rëndësishëm i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është respektimi dhe promovimi i diversitetit kulturor dhe gjuhësor në komunitetet lokale dhe krijimi i politikave të adaptuara për realitetet lokale. Kjo përfshin mbështetjen e iniciativave për të ruajtur, zhvilluar dhe promovuar trashëgiminë kulturore të secilit komunitet, duke krijuar një mjedis të përbashkët që respekton dhe vlerëson veçoritë dalluese kulturore dhe gjuhësore.

Vetëqeverisja lokale nxit krijimin e partneriteteve strategjike mes autoriteteve lokale, biznesit, dhe sektorit të arsimit, duke inkurajuar inovacionin dhe investimet në zhvillimin e infrastrukturës, arsimit, dhe shëndetësisë në nivel lokal. Kjo gjithashtu mund të kontribuojë në zbatimin e politikave mjedisore dhe zbatimin e standardeve të qëndrueshme, duke ndihmuar në ruajtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore lokale. Përveç kësaj, vetëqeverisja lokale ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e krizave dhe emergjencave në nivel lokal, pasi e njeh më mirë realitetin vendas dhe ka kapacitetin për reagim të shpejtë. Kjo i jep komunitetit një ndjenjë të siguri dhe përgatitjes për sfida të ndryshme, duke krijuar një atmosferë më reziliente dhe të përkujdesur për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve.

Vetëqeverisja lokale kontribuon në avancimin e kulturës së pjesëmarrjes dhe dialogut shoqëror. Duke organizuar konsultime publike dhe sesione të hapura, autoritetet lokale mund të ndërtojnë lidhje të forta me komunitetin dhe të ndërtuar marrëdhënie transparente. Kjo gjithashtu mund të thellojë ndjenjën e identitetit lokal dhe kujdesin për trashëgiminë kulturore, duke promovuar evente kulturore dhe aktivitete që e pasurojnë jetën sociale të qytetarëve. Përtej kësaj, vetëqeverisja lokale ka një ndikim thelbësor në zvogëlimin e pabarazive sociale dhe territoriale. Duke përqëndruar burimet dhe investimet në zonat me nevojat më të mëdha, ajo kontribuon në rritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e mundësive për zhvillim të barabartë. Kjo shërben si një instrument për zvogëlimin e hendekut

midis qytetit dhe zonave rurale, duke krijuar një shoqëri më të ekuilibruar dhe të përfshirë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Një aspekt themelor i vetëqeverisjes lokale është ndërtimi i kapacitetit administrativ dhe fuqizimi i zyrtarëve lokalë. Kjo përfshin trajnimet, shkollimin dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për të menaxhuar efektivisht çështjet lokale. Fuqizimi i administratës lokale rrit kompetencat e tyre për të ofruar shërbime publike kualitative dhe për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë në nivel lokal, duke kontribuar kështu në një qeverisje më efikase dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Një tjetër karakteristikë tipike është përqëndrimi në zhvillimin ekonomik lokal, duke inkurajuar iniciativat e biznesit lokal dhe krijimin e vendeve të punës. Konsolidimi i kapaciteteve administrative dhe përdorimi i teknologjisë për përmirësimin e shërbimeve janë gjithashtu elemente kryesore të vetëqeverisjes lokale. Një ndër treguesit e rëndësishëm është gjithashtu aftësia për menaxhimin e burimeve financiare në mënyrë efikase, duke siguruar që investimet dhe shpenzimet të reflektojnë nevojat reale të komunitetit dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve. Një aspekt shtesë i rëndësishëm është krijimi i një kulture të përgjegjshme dhe të hapur në administratën lokale, ku llogaridhënia dhe transparenca janë thelbësore. Kjo përfshin zhvillimin e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së autoriteteve lokale, si dhe kujdesin për përfshirjen e grupeve të ndryshme dhe të marginalizuara në procesin vendimmarrës. Vetëqeverisja lokale po ashtu karakterizohet nga bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve lokale dhe atyre qendrore, duke krijuar një koordinim efikas për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të shërbimeve.

Në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vetëqeverisja lokale ndikon edhe në:

1. Përmbushjen e Nevojave Lokale: Vetëqeverisja lokale njeh më mirë sfidat dhe nevojat specifike të komuniteteve të tyre, duke mundësuar përshtatjen e politikave dhe shërbimeve në nivel lokal.
2. Rritjen e Pjesëmarrjes Qytetare: Sistemi i vetëqeverisjes lokale inkurajon qytetarët të jenë të përfshirë në zgjedhjen dhe implementimin e politikave, duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes aktive në jetën komunitare.
3. Favorizimin e Zhvillimit Ekonomik Lokal: Vetëqeverisja lokale ka rolin e saj në stimulimin e zhvillimit ekonomik lokal përmes krijimit të mjedisit të favorshëm për bizneset lokale, investimet dhe krijimin e vendeve të punës.
4. Rrjedhshmëria e Informacionit: Niveli lokal i vetëqeverisjes lokale mundëson një komunikim më të drejtpërdrejtë dhe efikas mes qytetarëve dhe autoriteteve, duke përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe transparencën.
5. Kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe natyrore: përmes projekteve lokale, vetëqeverisja lokale mund të

kujdeset për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, duke theksuar identitetin lokal dhe turizmin e qëndrueshëm. Ky kombinim i përpjekjeve lokale dhe koordinimi me politikat qendrore bën veteqeverisjen lokale një element kyç për zhvillimin dhe mirëqenien e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut.

HIPOTEZAT E PUNIMIT

Hipotezat e këtij punimi të Masterit janë:

- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një kategori specifike juridiko kushtetuese e ligjore, meqë baza juridike e ekzistencës parimore të saj është përcaktuar me Kushtetutën e RMV-së të vitit 1991 dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2002;
- Vetëqeverisja lokale është një e drejtë politike e qytetarëve dhe një nga vlerat themelore juridike të përcaktuara dhe parashikuara në rendin kushtetues nacional të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Vetëqeverisja lokale është një formë e qeverisjes politike lokale nëpërmjet komunave që shtrijnë dhe ushtrojnë pushtetin lokal ndaj popullatës lokale në një zonë territorialisht të caktuar në kuadër të një bashkësie shtetërore të caktuar;
- Vetëqeverisja lokale ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe transparencës në shërbimet publike, pasi qytetarët kanë akses më të drejtpërdrejtë dhe ndikim në vendimmarrjen. Kjo gjithashtu kontribuon në promovimin e diversitetit etnik, kulturor dhe ekonomik, duke inkurajuar iniciativat lokale dhe zhvillimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë lokale.

METODOLOGJIA HULUMTUESE

Për shqyrtimin dhe trajtimin hulumtues teoriko-praktik juridik të çështjeve dhe fenomeneve nga tema e punimit të Masterit do të përdoren disa metoda të caktuara, siç janë:

- Metoda e deduksionit është aplikuar për të shqyrtuar dhe trajtuar fenomenin e vetëqeverisjes lokale nga aspektet hyrëse të përgjithshme themelore, drejt aspekteve konkrete juridike që i referohen vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me të drejtën pozitive nacionale të saj;
- Metoda normativiste-juridike është shfrytëzuar për të vështuar dhe shtjelluar aspektet juridike përmbajtësore të zgjidhjeve normative të përcaktuara në Kushtetutën e RMV-së, dhe në Ligjin për vetëqeverisjen lokale të RMV-së;
- Metoda komparativo-juridike është zbatuar, në mënyrë që të detektohen dhe nxirren në pah zgjidhjet normative juridike të sanksionuara në aktet ligjore të shteteve të caktuara, që i destinohen organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale.

KAPITULLI I

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME HYRËSE MBI VETËQEVERISJEN LOKALE

1.1 Në përgjithësi mbi zhvillimin historik të vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale ndryshon nga një shtet në një shtet tjetër, në përputhje me traditën politiko-juridike dhe kushtet e rrethanat specifike socio-ekonomike. Sot, vetëqeverisja lokale shpesh përfshin një gamë të gjerë të çështjeve, duke filluar nga shërbimet lokale, planifikimi urban, edukimi lokal, dhe të tjera. Kjo siguron pjesëmarrje aktive të komuniteteve në proceset vendimmarrëse dhe menaxhuese, duke ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenies së përgjithshme të komunitetit. Historikisht, vetëqeverisja lokale ka rrënjë të thella në periudhën e lashtë, kur komunitetet lokale kishin autonomi më të madhe. Në kohërat e lashta, fshatrat dhe qytetet kishin një gradë të lartë autonomie dhe merrnin vendime për nevojat e tyre lokale. Kjo shfaqje e vetëqeverisjes lokale mund të shihet në civilizimet antike të Greqisë dhe Romës, ku polisat dhe komunat kishin një gradë të lartë të pavarësisë në vendimmarrje. Vetëqeverisja lokale është një koncept i rëndësishëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe përfshin një kulturë të zhvilluar të angazhimit qytetar. Ajo krijon një mjedis ku vendimmarrjet janë të afërta me nevojat dhe realitetin lokal. Në një nivel më të thellë, vetëqeverisja lokale përfshin krijimin e një strukture qeverisëse që lejon komunitetet lokale të formojnë dhe të implementojnë politika publike lokale në përputhje me nevojat e tyre specifike. Ky proces shpesh mund të ndikojë në aspekte të tilla si arsimi lokal, shëndetësia, infrastruktura, dhe shërbimet sociale. Vetëqeverisja lokale gjithashtu ka një ndikim të thellë në demokracinë, pasi lejon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin vendimmarrës. Në këtë mënyrë, ajo ndihmon në kultivimin e një shoqërie më inclusive dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Nga një perspektivë historike, mund të theksohet se vetëqeverisja lokale është një rrjedhojë e zhvillimit të shoqërisë dhe ndryshimeve të strukturave sociale. Në periudhat e hershme, kur komunitetet ishin të vogla dhe autonome, ata kishin nevojë për një mënyrë organizimi dhe vendimmarrjeje që të reflektojë nevojat dhe vlerat e tyre specifike. Në shekullin e 19-të dhe 20-të, me industrializimin dhe urbanizimin, shpesh ndodhën ndryshime të mëdha në strukturën sociale dhe ekonomike. Kjo solli me vete nevojën për një qeverisje lokale të përshtatur me këto kushte të reja. Rritja e qyteteve dhe fshatrave shpesh çoi në një sfidë për të mbajtur lidhjen me qeverinë qendrore, dhe prandaj u bë e rëndësishme përmirësimi i vetëqeverisjes lokale. Në periudhën e fundit, koncepti i "qytetarit aktiv" ka qenë në qendër të diskutimeve mbi

vetëqeverisjen lokale. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin vendimmarrës, përfshirja në këshillat lokale dhe diskutimet komunitare janë elemente kyçe që promovojnë përgjegjshmërinë dhe transparencën në nivel lokal. Përveç kësaj, rëndësia e vetëqeverisjes lokale është theksuar edhe në ndryshimet aktuale globale, si përpjekjet për zbatimin e qeverisjes së mirë dhe për të adresuar sfidat e përbashkëta, duke e bërë atë një komponent të rëndësishëm të zhvillimit konzistent demokracisë lokale. Historikisht, vetëqeverisja lokale ka evoluar nëpër kohë duke reflektuar ndryshimet në shoqëri dhe strukturën e pushtetit. Në periudhat e lashta, polisat dhe komunat në Greqi dhe Romë ishin modele të hershme të vetëqeverisjes lokale, duke demonstruar autonomi dhe pavarësi lokale në vendimmarrje. Për më tepër, shembujt nga shtetet e ndryshme tregojnë se vetëqeverisja lokale nuk është një model i vetëm, por përshtatet me kontekstin kulturor dhe historik të secilës shoqëri. Sot, me sfidat globale si ndryshimet klimatike dhe pandemitë, vetëqeverisja lokale po e gjen veten në rolin e një aktori kyç për menaxhimin e krizave dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë arsye, investimet në kapacitetet lokale dhe përmirësimi i proceseve vendimmarrëse janë bërë thelbësore për të adresuar sfidat e kohës së sotme. Në vijim vlen të theksohet disa aspekte shtesë të vetëqeverisjes lokale:

1. Diversiteti Kulturor dhe Konteksti Lokal: Vetëqeverisja lokale shpesh formohet dhe ndryshon në përputhje me kulturën dhe kontekstin lokal të një shteti konkret. Rrethanat historike, traditat dhe vlerat lokale kanë ndikim thelbësor në modelin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale.
2. Financimi Lokal: Sigurimi i burimeve financiare është një sfidë kryesore për shumicën e njësive të vetëqeverisjes lokale. Në disa raste, vetëqeverisja lokale mund të ketë vështirësi në financimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme. Diskutimet për burimet financiare dhe autonomia financiare janë pjesë e debatit rreth vetëqeverisjes lokale.
3. Ndikimi i Teknologjisë: Zhvillimi i teknologjisë ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në vetëqeverisjen lokale. Përdorimi i teknologjisë informatike dhe komunikative mund të përmirësojë transparencën, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe efikasitetin e shërbimeve lokale.
4. Trendet Bashkëkohore të Qeverisjes: Konceptet bashkëkohore të qeverisjes, si qeverisja e hapur dhe pjesëmarrja e qytetarëve, gjithashtu kanë një impakt të rëndësishëm në vetëqeverisjen lokale. Përdorimi i teknologjisë për konsultim publik dhe informacionin e hapur është një ndër praktikatat e përdorura gjithnjë e më shumë.
5. Ndërlidhja Ndërkombëtare: Në një botë të globalizuar, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërlidhja e njësive të vetëqeverisjes lokale me organizata ndërkombëtare janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme. Këto lidhje mund të sjellin përvoja të përbashkëta, shkëmbime të njohurive, dhe mbështetje për zgjidhjen e sfidave të përbashkëta. Vetëqeverisja

lokale, duke u përshtatur me këto aspekte, mund të jenë një force e rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të zhvilluar komunitetet në mënyrë që të përballojnë sfidat e kohës së sotme. Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë shtete filluan të thellojnë përpjekjet për të ristrukturuar administratën e tyre lokale, duke e bërë më të pavarur dhe të përfshirë në procesin vendimmarrës. Këto ndryshime janë shpesh pjesë e një konteksti më të gjerë ndërkombëtar të përpjekjeve për të forcuar demokracinë dhe pjesëmarrjen civile. Në vitet 60 dhe 70, disa vende filluan të eksperimentojnë me modele të reja të vetëqeverisjes lokale. Kjo përfshinte përmirësimin e financimit lokal, forcimin e kapaciteteve institucionale lokale, dhe rritjen e përgjegjësisë të njësive të qeverisjes lokale. Kjo periudhë shënoi një ndryshim nga qeverisja qendrore drejt një modeli më të decentralizuar. Në vitet 80, shpërthimi i lëvizjeve demokratike në disa shtete komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore solli një këndvështrim të ri ndaj autonomisë lokale. Pas rënies së regjimeve komuniste, shumë prej tyre filluan të ndryshojnë sistemet e tyre të administratës lokale duke e forcuar pjesëmarrjen lokale dhe autonominë. Procesi i integritit evropian gjithashtu ka shqyrtuar dhe ndikuar në strukturat e vetëqeverisjes lokale. Kriteret dhe standardet e Unionit Evropian kanë kërkuar përmirësime në administratën lokale për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje të gjerë nga qytetarët në procesin vendimmarrës. Në ditët e sotme, një nga sfidat kryesore që shumica e shteteve përballen me vetëqeverisjen lokale është çështja e financimit. Njësisë e qeverisjes lokale i duhet të ketë burime të mjaftueshme për të plotësuar nevojat dhe detyrimet e saj. Shumë herë, kjo përfshin një kërkim të vazhdueshëm për balancimin e të hyrave publike lokale dhe bllok-dotacioneve qeveritare. Në aspektin e pjesëmarrjes së komunitetit, ka një përpjekje të vazhdueshme për të rritur konsultimet dhe dialogun me qytetarët në procesin vendimmarrës. Përdorimi i teknologjisë moderne dhe platformave online ka shpërblyer këtë pjesëmarrje dhe ka bërë që vendimmarrja lokale të jetë më transparente dhe të hapur për kontributin e qytetarëve. Një aspekt i rëndësishëm është edhe çështja e kapacitetit institucional administrativ lokal. Përmirësimi i kapaciteteve të punonjësve të administratës lokale dhe zhvillimi i tyre në fushën e planifikimit urban, menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe administratës financiare janë thirrje të vazhdueshme për të siguruar një vetëqeverisje efektive dhe efikase. Në një nivel më të gjerë, tendenca e sotme e decentralizimit po vazhdon, duke e bërë vetëqeverisjen lokale një aktor kyç në zhvillimin rajonal dhe nacional. Në shumicën e shteteve, procesi i vetëqeverisjes lokale është ndërthurur ngushtë me zhvillimin ekonomik, social, dhe mjedisor. Një aspekt i rëndësishëm ka qenë transferimi i kompetencave dhe përgjegjësisë lokale në fusha të tilla si shëndetësia,

arsimi, infrastruktura, dhe zhvillimi ekonomik. Kjo ka synuar të forcojë kapacitetet lokale institucionale për të adresuar nevojat specifike të komuniteteve. Ndërkohë, sfida e tërheqjes dhe ruajtjes së ekspertizës lokale ka shtuar rëndësinë e trajnimit dhe përmirësimit të punonjësve të administratës lokale. Krijimi i profileve profesionale dhe programeve të specializuara ka qëlluar të krijojë një administratë të aftë dhe të kompetentë për të menaxhuar sfidat e njësisë administrative lokale. Në disa shtete, ka ndodhur një lëvizje drejt decentralizimit të fuqive të pushtetit qendror në favor të një vetëqeverisjeje më autonome lokale. Duke u përpjekur për të adresuar çështjet komplekse dhe emergjente si ndryshimet klimatike dhe sfidat mjedisore, disa vende kanë fokusuar në integrimin e politikave të qeverisjes lokale me agjendat globale të qëndrueshme. Kjo përfshin përdorimin e inovacioneve dhe teknologjisë për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të përmbushur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në përgjithësi, vetëqeverisja lokale po evoluon për të reflektuar nevojat e një shoqërie të ndryshme dhe sfidat e kohës së sotme, duke u përpjekur për të mbajtur një balancë midis autonomisë lokale dhe koordinimit efektiv në nivelin nacional.¹

Nga pikëpamja e avancimeve në vetëqeverisjen lokale, janë shfaqur tendenca të reja si përdorimi i teknologjisë së informacionit për të përmirësuar shërbimet dhe komunikimin me qytetarët. Aplikacionet mobile, platformat online dhe të dhënat e hapura janë shfrytëzuar për të ndihmuar në monitorimin e projekteve lokale, përcjelljen e informacionit publik, dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Në disa shtete, janë shpallur iniciativa për të inkurajuar krijimin e partneriteteve ndërmjet sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile në nivel lokal. Kjo ka për qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillim ekonomik dhe përmbushjen e nevojave të komunitetit përmes bashkëpunimit të shumë aktorëve. Sfidat e lidhura me përfshirjen dhe përfaqësimin e barabartë të të gjitha grupeve shoqërore në proceset vendimmarrëse janë ende në qendër të diskutimeve. Për të adresuar këto çështje, disa vende kanë përdorur kuota të rezervuara për pjesëmarrjen e grave dhe të minoriteteve në organet lokale, ndërsa janë zhvilluar edhe programe për të inkurajuar angazhimin e të rinjve. Në lidhje me aspektin ekologjik, disa qytete kanë shpallur iniciativa për të krijuar mjedise të qytetëruara të qëndrueshme, duke investuar në të mirat publike, transportin publik, zonat e gjelbëruara dhe mjedis të shëndetshëm ekologjik. Kjo reflekton një ndërgjegjësim të rritur

¹ Shih: David J. McNeil, Charles H. Koch Jr, Local Government Law; David L. Selden, Jaroslav Krecji, Comparative Local Government: An Overview; George L. Nemhauser dhe Harvey J. Greenberg, Local Government and Strategic Choice: An Operational Research Approach to the Processes of Public Planning; R. A. W. Rhodes, Local Government in the Modern State.

lidhur me nevojën për të menaxhuar burimet natyrore në nivel lokal. Në një këndvështrim global, shumë shtete kanë ndjekur eksperiencën dhe mësimet e shteteve të tjera për të përmirësuar vetëqeverisjen lokale. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është bërë një aspekt i rëndësishëm për të shkëmbyer praktikën më të mirë dhe për të adresuar sfidat komplekse që përfshijnë shërbimet publike, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin mjedisor në nivel lokal. Në shekullin 20, shpërthimi i nacionalizmit dhe proceset e pavarësisë pas Luftës së Parë Botërore sjellën një rritje të interesit për vetëqeverisjen lokale. Ndër luftërat botërore, disa vende filluan të zhvillojnë sisteme të reja administrative, duke përfshirë dhe fuqizuar autoritetet lokale. Në shekullin 21, digitalizimi dhe globalizimi kanë ndikuar në rritjen e përgjegjësisë lokale. Përfaqësuesit lokalë janë sfiduar nga nevoja për të menaxhuar çështje si zhvillimi ekonomik lokal, infrastruktura, dhe shërbimet sociale, duke ndikuar në thellimin e vetëqeverisjes lokale. Sidoqoftë, shfaqja e sfidave komplekse si pandemia COVID-19 ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit në nivel lokal për të mbrojtur qytetarët dhe për të menaxhuar emergjencat aktuale. Pra, me kalimin e kohës në shekullin 21, koncepti i vetëqeverisjes lokale është ndryshuar për t'u përshtatur me sfidat bashkëkohore. Ndryshimet teknologjike kanë sjellë mundësi të reja për pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe për monitorimin e performancës së autoriteteve lokale. Në esencë, vetëqeverisja lokale ka kaluar një rrugë të gjatë dhe të përbashkët gjatë shekullit 20 dhe 21, duke u adaptuar ndaj ndryshimeve historike dhe sfidave bashkëkohore për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie për komunitetet.²

1.2 Kahjet e zhvillimit të pushtetit lokal

Pushteti lokal paraqitet në Angli kah fundi i shekullit të XV kur me konventat solemne të mbretërve apo të feudalëve të lartë iu është dhënë qyteteve të caktuara vetëqeverisja si privilegj i veçantë. Kushtetuta e SHBA-ve nuk e trajton çështjen e vetëqeverisjes lokale. Për shkak të kësaj në Amerikë funksionojnë sisteme të ndryshme të vetëqeverisjes lokale. Jetojmë në një botë të kundërthënshme. Sot gjithnjë e më shumë qytetarët kërkojnë liri dhe të drejta, të vendosin drejtëprdrejt për ekzistencën e tyre, të qeverisin më shumë me punët publike, për më shumë demokraci dhe një shoqëri civile. Nuk

² Shih: David J. McNeil, Charles H. Koch Jr, Local Government Law; David L. Selden, Jaroslav Krecji, Comparative Local Government: An Overview; George L. Nemhauser dhe Harvey J. Greenberg, Local Government and Strategic Choice: An Operational Research Approach to the Processes of Public Planning; R. A. W. Rhodes, Local Government in the Modern State.

ka sistem politik demokratik pa zhvillimin e pushtetit lokal. As që nuk mund të ketë, shoqëri civile pa të vendosurit e pavarur për çështjet lokale (lokusi). Bota është e shtypur nga shtetet glamoze, burokratike, ekonomike dhe sistemet teknologjike. Të gjitha këto sisteme globale me nënsistemet e tyre paraqesin rrezik për autonominë territoriale të çdo lloji, por edhe të njeriut. Pushtetit lokal sot gjithnjë e më shumë i kanoset marginalizimi. Këto mund të tejkalohen me decentralizimin dhe vetëqeverisjen lokale, me ndërtimin e shtetit funksional dhe tejkalimin e hendekut të madh midis pushtetit qendror dhe lokal. Evropa moderne është evropa e decentralizimit. “Komunologët” modern gjyrmojnë pas teorive dhe koncepteve të reja mbi pushtetin lokal, pas formave dhe mënyrave të reja për pjesëmarrjen e qytetarëve me udhëheqjen e punëve lokale, në përputhje me shoqërin industriale e postindustriale dhe environmentin e tyre.³

1.3 Nocioni, rëndësia dhe karakteristikat themelore të pushtetit lokal

Pushteti lokal është kategori e sistemit politik dhe kushtetues të një shteti të caktuar. Pozita dhe rëndësia e pushtetit lokal është e ndryshme në shtete të ndryshme, ku ekziston një dallim i theksuar në statusin dhe shkallën e vetëqeverisjes të pushtetit lokal. Pushteti lokal do të thotë udhëheqja dhe vendosja e qytetarëve në bashkësinë lokale për çështjet me rëndësi lokale. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendosje mund të jetë e drejtëpërdrejtë, nëpërmjet tubimit të qytetarëve, iniciativës qytetare dhe referendumit, apo në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet organeve të komunës. Pushteti lokal emërtohet me emërtime të ndryshme, p.sh., në Angli emërtohet si pushtet lokal (*local government*), në Zvicër autonomia lokale (*autonomi local*), por dhe demokracia komunale (*die gemeindedemokratie*), në Francë njësitë territoriale (*collectivites territoriales*), në Gjermani vetëqeverisje komunale (*kommunale verëaltung*) dhe në Maqedoni pushteti lokal. Pushteti lokal sipas *Redfield* paraqet ushtrim të pushtetit nga ana e qytetarëve në kuadër të lokusit, respektivisht nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, ushtrimin e funksioneve dhe ingerencave që ua ka dhënë ligjvënësi apo që u takojnë në bazë të së drejtës zakonore. Sipas teoricienit anglez *Robertson* pushteti lokal, paraqet ekzistimin e bashkësis së pavarur territoriale i cili me ligj i ka të përcaktuara të drejtat dhe mënyrën e organizimit të punëve të tij. Medoemos duhet të ekzistoj pushteti lokal me autorizime normative, i pavarur nga kontrolli i jashtëm, si dhe pjesëmarrja e bashkësis lokale në qeverisjen e punëve të saja. Sipas teoricienit tjetër *Anderson* pushteti lokal i ka këto

³ Mersim Maksuti, E Drejta Kushtetuese, Strugë, 2024, fq. 406-407.

karakteristika: territorin; popullatën; organizimin; identitetin e veçantë juridik; autonominë; autorizimet dhe ushtrimin e funksioneve, si dhe pavarësin fiskale. Që të ekzistoj pushteti lokal i vërtetë, në radhë të parë duhet të sigurohet baza kushtetuese dhe ligjore e rregullimit të pavarësisë së tij në kuadër të sistemit politik të një vendi (te garantuara edhe me Kartën Evropiane mbi pushtetin lokal).

E drejta e pushtetit lokal nënkupton të drejtën e qytetarëve të vendosin për çështjet lokale. Sipas Kartës Evropiane mbi pushtetin lokal, “qeverisja lokale nënkupton të drejtën dhe mundësitë e pushtetit lokal, në kuadër të ligjit, ti rregullojnë dhe të udhëheqin me çështjet më të rëndësishme publike, në bazë të përgjegjësisë së tyre dhe në interes të popullatës lokale”. Qytetarët e bashkësisë lokale mund të vendosin drejtpërdrejt apo nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura lokale dhe nga ana e funksionerëve lokal që i zgjedhin ato organe përfaqësuese. Një nga çështjet më të rëndësishme të pushtetit lokal, është rrethveprimtaria e tij. Pushteti lokal tradicionalisht ushtron punët të cilat janë në interes të qytetarëve të cilët jetojnë në atë njësi lokale, që njihen ndryshe në shumë vende si punë me “rëndësi lokale”. Ndërsa, organet e shtetit kanë të drejtë dhe obligim të kujdesen për çështjet që kanë të bëjnë me gjithë territorin e shtetit dhe për rregullimin e marrëdhënieve në të. Rregull e përgjithshme, është që një pjesë, të funksioneve në njësinë lokale të ushtrohen nga organet lokale, ndërsa një pjesë tjetër të jenë nën kompetencë të organeve qendrore. Rrethi i parë i punëve konsiderohet si decentralizim dhe ushtrohet nga organet lokale, ndërsa i dyti dekokentrim dhe ushtrohet nga ekspoziturat lokale të pushtetit qendror. Konventa Evropiane mbi pushtetin lokal mbështetet mbi disa parime në organizimin dhe funksionimin e tij, siq janë:

- Parimi i parë, definimi i punëve lokale bëhet me ligj mbi qeverisjen lokale aq sa ia ka përcaktuar ligjvënësi në bazë të kushtetutes,
- Parimi i dytë, përcakton që organet lokale, në kuadër të ligjit kanë diskrecion të plotë të realizojnë iniciativat e tyre lidhur me të gjitha çështjet që u takojnë,
- Parimi i tretë, mbështetet në atë që punët publike ushtrohen në radhë të parë nga organet që janë më afër qytetarëve,
- Parimi i katërt, funksionet që iu besohen organeve lokale, si rregull, janë të plota dhe të ndara,
- Parimi i pestë, në rastet e bartjes së kompetencave nga organet qendrore dhe regjionale në ato lokale, organeve lokale iu lejohet që në masë më të madhe zbatimin e tyre t’ua përshtasin kushteve lokale, dhe

- Parimi i gjashtë, organet lokale, në kohë dhe mënyrën më të mirë, konsultohen në procesin e planifikimit dhe sjelljes së vendimeve për të gjitha çështjet që ato i tangojnë. Mbrojtja juridike e pushtetit lokal mund të jetë e ndryshme dhe nga organe të ndryshme, varësisht nga karakteri i cënimit: gjykata kushtetuese mbron nga aspekti juridik pushtetin lokal nëse ndonjë akt i përgjithshëm juridik cenon të drejtat dhe statusin e pushtetit lokal, të garantuara me kushtetutë dhe me ligje; gjykatat e rregullta, nëse cënimi i të drejtave të saj është bërë nëpërmjet ndonjë veprimi apo akti individual; avokati i popullit nëse cenimi është bërë nga ndonjë akt administrativ i organeve të administratës shtetërore apo nga ndonjë institucion që ushtrojnë autorizime publike, siç është p.sh., avokatura. Pushteti lokal, në esencë, paraqet institucionin themelor të demokracisë, pa të cilën asnjë sistem i qeverisjes nuk mund të jetë demokratik dhe legjitim. “Praktika e pushtetit lokal është mësimi më i mirë i demokracisë dhe garancia më e mirë e suksesit të saj”. Ndarja territoriale për zhvillimin e pushtetit lokal paraqet rëndësi të veçantë, që nëpërmjet saj vijnë në shprehje disa faktor: hapësira e territorit të njësisë së qeverisjes lokale, numri i qytetarëve, kufijtë e interesave dhe nevojave lokale, si dhe lloji dhe masa e veprimtarive me realizimin e të cilave plotësohen ato interesa. Lidhur me mbrojtjen e kufijve të njësive të pushtetit lokal Karta Evropiane përcakton se “Kufijtë në territorin e të cilit shtrihen kompetencat e organeve lokale nuk guxojnë të ndryshohen pa konsultim paraprak të njësive lokale që janë në pyetje, ndërsa përderisa ajo është e mundur, me anë të referendumit kur ai është i paraparë me ligj”. Ndërsa, lidhur me organizimin e administratës dhe burimeve të mjeteve për realizimin e detyrave të organeve lokale, Karta Evropiane i’u garanton njësive lokale, të drejtën në organet e tyre të administratës dhe kuadrin profesional në te. Sipas Kartës, për bartësit e funksioneve lokale duhet të vlejë këto rregulla: “kushtet për punë të tyre të jenë të tilla që t’iu mundësojnë ushtrimin e lirë të funksioneve; këto kushte nënkuptojnë edhe kompenzimin financiar adekuat të shpenzimeve për ushtrimin e atyre funksioneve. Dhe në fund të gjitha funksionet të cilat konsiderohen inkompatibile me ushtrimin e detyrës funksioner lokal rregullohen me ligj apo me parimet bazë juridike”. Çështja e raportit midis organeve shtetërore dhe atyre lokale është e mbështetur mbi parimin e pavarësisë dhe vetëqeverisjes me çështjet lokale, duke iu rezervuar e drejta organeve shtetërore kontrollin e ligjshmërisë mbi punën e tyre. Karta përcakton se çdo formë e mbikqyrjes administrative të punës organeve lokale nga ato qendrore është e përcaktuar me kushtetutë dhe ligj. Sipas Kartës “Intervenimi i organit që kontrollon duhet të jetë në proporcion me rëndësinë e interesit që duhet të mbrohet”. Organet lokale jo vetëm që duhet të kenë mjetet e tyre financiare por ato duhet në mënyrë të pavarur

të vendosin mbi ato mjete. Pa këtë qeverisja lokale do të duket si një deklaron i thjeshtë pa rëndësi reale në sistemin politik. Mjetet financiare përfshijnë ato që burimisht u takojnë organeve lokale dhe mjetet që i siguron shteti (duke rezervuar edhe të drejtën e kontrollit mbi harxhimin e atyre mjeteve). Sipas Kartës, burimet e finansimit të organeve lokale, duhet të jenë në pajtim me politiken ekonomike të vendit që është e definuar me kushtetutë dhe ligj të çdo shteti. Më tutje, Karta përcakton se, një pjesë e mjeteve të organeve lokale buron nga taksat lokale dhe kontributet tjera të rregulluara me ligj. Karta lejon mundësin për më shumë sisteme të financimit mbi të cilat mbështeten burimet e mjeteve të organeve lokale. Mjetet që u lëshohen organeve lokale nuk duhet të kenë kualifikativin e “mjeteve të dedikuara” por më shumë t’u lihet e drejtë diskrecionale organeve vendore për menaxhimin e tyre në përputhje me politikën e tyre lokale. Përvoja evropiane në drejtim të financimit të organeve lokale tregon praktika të njëjta (nga shteti dhe vetjake) por pjesëmarrja e tyre është e ndryshme.⁴

1.4. Pushteti lokal-decentralizimi dhe dekoncentrimi

Në teori është delikate ndarja e pushtetit lokal nga decentralizimi. Me decentralizim në kuptimin më të plotë nënkuptojmë çdo lloj anticentrizmi, respektivisht ekzistimin e më shumë organizmave të pavarura të vendosjes të cilët kanë me shumë apo më pak të drejta vetadministrative në një territor të caktuar. Decentralizimi si nocion nënkupton bartjen e funksioneve të caktuara nga organet qendrore në ato lokale. Edhe pse organizimi shtetëror në rastin e decentralizimit dhe dekoncentrimit ushtrohet nga organet lokale, midis tyre ekziston dallim thelbësor. Dekoncentrimi paraqet formën tekniko-administrative të centralizimit. Organet që ekzistojnë në sistemin e dekoncentrimit gjithmonë emërohen nga organet qendrore, ndërsa aktet e tyre, nxirren në bazë të udhëzimeve të detyrueshme nga organet qendrore. Për dallim nga kjo, organet e decentralizuara, si rregull, zgjedhen (nuk emërohen) nga qytetarët. Aktet e këtyre organeve i’u nënshtrohen vetëm kontrollit juridikë të ligjshmërisë.⁵

⁴ Mersim Maksuti, E Drejta Kushtetuese, Strugë, 2024, fq. 407-411.

⁵ Ibidem., fq. 411.

1.5 Pushteti lokal dhe regjionalizmi

Nocioni region ka kuptim shumëdimensional: gjeografik, politiko-territorial, ekonomik, sociologjik, juridik, etj. Për region mund të flasim në kuptimin brenda një shteti, komparativ, evropian por edhe për regjione në kuadër të gjithë botës. Regjioni nënkupton territorin që përfshinë një tërësi hapësinore, e aftë dhe adekuate për zhvillimin ekonomik, politik, institucional dhe juridik, me një shkallë të caktuar të pavarësisë (më pak apo më shumë) në raport me pushtetin qendror që vjen në shprehje nëpërmjet organizimit, kompetencave si dhe financimit të vet. Regjionalizmi si proces i krijimit të etnive territoriale të decentralizuara është prezent si në shtetet unitare ashtu edhe në ato të përbëra. Ato, emërtohen si: area, district, paysage, landschaft, territor, brez, zone, reon, etj. Në kuptimin politik-territorial regjioni është tërësi shoqërore-ekonomike dhe politike (njësi) më e ngushtë se njësitë federale dhe njësitë autonome, ndërsa më e gjerë se njësitë themelore territoriale. Qëllimi themelor i regjionalizmit është të kufizojë centralizmin. Gjithashtu, regjionalizmi është i drejtuar kundër monopolizmit kulturor dhe politik. Duke i tejkaluar kufijtë lokal dhe partikularizmin, regjionalizmi shpien në zhvillim më të shpejt. Regjionalizmi modern paraqitet në Francë në shek.VIII, si proces i orientuar kundër koncentrimit dhe centralizmit enorm të prodhimtarisë, kapitalit, administratës dhe kulturës. Jetojmë në kohën e integritetit të madh evropian. Proceset integruese e problematizojnë shtetin sovran nacional dhe promovojnë regjionet si tërësi kulturore dhe ekonomike, të cilat synojnë integrimet më të mëdha, shoqëritë mbinacionale. Regjionalizmi përfshiu Gjermanin, Holandën, Francën, Britanin, Greqinë, Poloninë dhe vendet tjera evropiane me qëllim të balancimit në zhvillimin e pjesëve të caktuara. Dimenzioni ekonomik është me rëndësi të veçantë në procesin e regjionalizimit dhe kjo do të thotë zhvillimin i barabartë dhe i balansuar i njësive lokale. Evropa e së ardhmes është evropë e regjioneve dhe jo e shteteve. Kemi disa tipe regjionesh: në shtetet federative (Gjermani, Austri, Zvicër, Belgjikë dhe Rusi (1993), në të cilat regjionet kanë kompetenca të gjera ligjvënëse. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe Spanja dhe Italia edhe pse janë shtete unitare. Në grupin e dytë hyjnë shtetet e Evropës qendrore dhe të lindjes në të cilat regjionet janë të vendosura si shkallë e tretë e pushtetit lokal (Polonia, Çekia, Sllovakia, Sllovenia, Bullgaria, Letonia, Lituania, Shqipëria, Ukraina, Kroacia dhe Gruzia). Grupi i tretë i shteteve (të ashtuquajtur të Evropës Veriore dhe ishujt Britanik) e përbëjnë Mbretëria e Bashkuar, Irlanda Veriore, Holanda, Danimarka, Norvegjia, Suedia, Finlanda dhe Islanda. Te këto shtete niveli regjional me shumë paraqet formë administrative të organizimit territorial se sa politike. Grupi i katërt i shteteve me organizim regjional (Franca, Portugalia

dhe vendet mediterane) janë tradicionalisht të centralizuara, shtete unitare në të cilat regjionet kanë karakter vetëm administrative. Lidhur me regjionalizmin vlen të theksohet: se nuk ka nevojë për shtetet e vogla; se në disa shtete ekziston rreziku të transformohet në secesion (ndarjen e shtetit), edhe pse edhe centralizmi mund të shkaktojë kërkesa ekstreme; regjionet mund ta rrezikojnë autonominë e pushtetit lokal, përderisa parimi i supsidiaritetit nuk garantohet; duhet të pamundësohet burokratizimi regjional.⁶

1.6 Pushteti lokal në disa shtete

Gjatë historisë së zhvillimit të pushtetit lokal kanë ekzistuar dhe ekzistojnë tipe të ndryshme të tij. Pos kësaj, edhe brenda një shteti mund të ekzistojnë forma të ndryshme të pushtetit lokal si p.sh., në SHBA, që përndryshe konsiderohet si nja nga vendet ku ka lindur pushteti lokal, krahas Anglisë dhe Zvicrës. Në **SHBA**, pushteti lokal është një nga më të ndërlikuarit në botë, ngase kjo është lënë të rregullohet në ingerencë të njësive federative. Këtu, kemi disa forma të pushtetit lokal: e para, është këshilli-kryetari (mer); e dyta, nëpërmjet sistemit të komisionerit dhe, e treta, këshilli-menaxheri. Forma e parë, e vetëqeverisjes së qytetit **këshilli-kryetari** është më e vjetra (sh.XIX) në SHBA. Organe e tij janë: këshilli, kryetari i qytetit dhe organet administrative. Këshillin e qytetit si dhe Kryetarin e zgjedhin qytetarët në zgjedhje. Kemi dy tipe të kësaj forme: me kryetar të fort dhe të dobët. Kryetari i fort ka të drejtën e vetos së vendimeve të këshillit dhe është i plotëfuqishëm në ushtrimin e punëve të përditshme të qeverisjes. Tiparet e kryetarit të qytetit i ngjajnë atij të presidentit të SHBA-ve apo guvernatorit të shtetit. Kryetari i dobët i kësaj forme të pushtetit lokal, ka kompetenca gati ceremoniale ku e drejta e vetos është mjaft e kufizuar, si dhe është i kufizuar edhe me udhëheqjen e organeve të caktuara administrative. Forma e dytë, e vetëqeverisjes së qytetit – **sistemi komisioner** erdhi si rezultat i përvojave negative të formës së parë të vetëqeverisjes së qytetit. Sipas kësaj forme, gjithë pushteti i qytetit i besohet një komisioni, i cili përbet prej 3-7 anëtarë, të cilët zgjedhen nga qytetarët. Komisioni në të njëjtën kohë është trup përfaqësues dhe komitet i shefave të funksionit ekzekutiv të qytetit. Forma e tretë, e organizimit të qeverisjes së qytetit **këshill-menaxher**, përbëhet nga këshilli dhe menaxheri i qytetit. Këshillin e zgjedhin qytetarët në zgjedhje të drejtëpërdrejta. Administratorin e zgjedh këshilli për kohë të pacaktuar dhe me kompetenca të plota në ushtrimin e funksioneve të qytetit. Sipas rregullit ai është njeri profesionist që udhëheq me

⁶ Mersim Maksuti, E Drejta Kushtetuese, Strugë, 2024, fq. 411-413.

qytetin i cili mund të mos jetë banor i qytetit. Në **Angli** pushteti lokal ekziston paralelisht me sistemin e pushtetit shtetëror (pushteti qendror). Kompetencat e pushtetit lokal i përcakton Parlamenti anglez, duke garantuar tre shkallë të pushtetit lokal: Shkalla e parë është **Parish**, shkalla e dytë është **Distrikti**, dhe shkalla e tretë është **qarku** (County). Parish është njësia themelore e pushtetit lokal dhe ato ekzistojnë që nga koha e mesjetës. Trupi përfaqësues i pushtetit lokal është këshilli lokal, ndërsa organet ekzekutive janë komitetet, të formuara për çështje të ndryshme (financë, arsim, shëndetësi, urbanizëm, etj). Në **Zvicër** pushteti lokal rregullohet me legjislacionin e kantoneve. Prandaj, çdo kanton ka disa specifika të veçanta në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të pushtetit lokal. Njësitë lokale janë vetëm komunat. Vullneti i qytetarëve të komunës shprehet nëpërmjet kuvendit komunal, referendumit dhe iniciativës popullore. Kuvendi komunal përbëhet prej qytetarëve aktiv të komunes, të cilet kohe pas kohe mbledhen në një vend për të shqyrtuar dhe vendosur për problemet kryesore të komunës, si organ më i lartë i saj. Referendumi organizohet për çështje të rëndësishme për zhvillimin e komunës. Për vendimet që sillen nga kuvendi komunal, në parim nuk organizohet referendum. Në disa komuna kemi kombinim të referendumit me vendimin e kuvendit komunal. Në komunat ku organi më i lartë është këshilli komunal, vendimet e këshillit i nënshtrohen edhe referendumit. Në disa komuna ku ekziston këshilli, të gjitha vendimet e tij vihen edhe në referendum të detyrueshëm ndërsa në disa komuna me këshill komunal referendumi është fakultativ. Në disa komuna disa vendime të këshillit komunal i nënshtrohen referendumit të detyruar, ndërsa një pjesë e vendimeve referendumit fakultativ. Në përgjithësi në Zvicër, referendumet fakultative janë në numër më të madh se ato të detyruar siq mendohet ndryshe. Të drejtën e shtruarjes së kërkesës për iniciativën popullore mund ta bëjnë 1/5 apo 1/10 e banorëve varësisht nga komunat (në praktikë rrallë ndodhë). Këshilli komunal zgjedhet nga qytetarët e komunës dhe i ka kompetencat e njëjta si kuvendi komunal në komunat ku ekziston. Në të gjitha komunat në Zvicër ekziston edhe këshilli ekzekutiv i cili udhëheq me punët e administratës lokale. Por, gjithashtu, ekziston edhe kryetari i komunës si organ individual i komunës. Në **Gjermani** pushteti lokal është disa shkallësh në nivel të njësive federale, të komunave dhe rretheve, respektivisht qyteteve të lira. Në Gjermani nuk ekziston ligji që rregullon pushtetin lokal por kjo çështje rregullohet vetëm me Kushtetutën federative, ndërsa më gjerësisht është lënë në kompetencë të njësive federative që me ligjet e tyre ta rregullojnë organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal. Qeverisja lokale gjermane karakterizohet me pushtet ekzekutiv të fuqishëm. Varësisht nga njësitë federale kryetarët e komunave quhen si burgermeister, gemainedirektor. Kryetari i

komunes si “oficer lokal” pavarësisht a është emëruar apo zgjedhur është personalitet shumë i vlerësuar. Komunat (gemeinden) dhe rrethet (kreis) i ushtrojnë të gjitha punët në territorin e tyre, derisa ato me ligje nuk i’u janë besuar njësive rajonale të pushtetit qendror. Kompetencat e komunave në themel janë: udhëheqja me regjistrin e popullatës dhe dhënia e dokumentave zyrtare, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, çerdheve të fëmijëve, shkollave fillore (ndonjëherë dhe për shkallët më të larta të arsimit), pregatitjen e planeve regjistruese, ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive, kujdesja për çështjet komunale, etj. Të hyrat më të mëdha i sigurojnë si të hyra ndihmesë nga pushteti qendror. Italia është e ndarë në 20 regjione, 95 provinca dhe rreth 8000 komuna. Qeverisja lokale është e rregulluar me ligjin e vitit 1990. Të gjitha komunat kanë përbërje dhe detyra të njejta, edhe pse ekziston tendenca për të ndryshuar kjo pasi madhësia e komunave është e ndryshme. Kompetencat e tyre kanë të bëjnë me: shërbimet shëndetësore, ndihma publike, banesat, punët publike, tregjet dhe panaiet, planifikimi hapësinor, policia lokale, ndërtimi dhe mirëmbajtja e shkollave dhe rrugëve lokale, objekteve sportive, etj. Organet e komunës janë: këshilli komunal, këshilli ekzekutiv dhe kryetari i komunës. Numri i anëtarëve të këshillit të komunës varion nga 15 deri në 80, me mandat 5 vjeçar. Këshilli komunal nga radhët e veta zgjedh kryetarin e komunës dhe një numër të caktuar të ndihmësve të tij. Komunat janë nën kontroll relativisht të fuqishëm nga pushteti qendror për arsye se ekzistojnë regjionet të cilat kanë disa të drejta të theksuara mbi themelimin e komunave. Ndarja administrative në Francë përfshin regjione, departamente dhe komuna. Komuna franceze është e garantuar me Kushtetutë, ndërsa të drejtat e saja janë të rregulluara me ligj. Komunat kanë mesatarisht nga 2000 banorë dhe gjithsej janë 36.433 komuna. Këshillat e komunave me nën 100 banorë përbëhen prej 9 anëtarëve, ndërsa ato me mbi 300.000 banorë përbëhen deri me 49 anëtarë. Parizi ka 109 anëtarë, Lioni-61, ndërsa Tulusi dhe Nica nga 49 anëtarë. Anëtarët e këshillave zgjedhen nga qytetarët drejtëpërdrejt dhe kanë mandat 6 vjeçar. Çdo këshill nga përbërja e vet zgjedh kryetarin e komunës (maire) dhe prej 2 deri në 13 delegatë varësisht nga numri i popullsisë, pushtetin ekzekutiv të komunës. Në kompetencë të kryetarit të komunës janë: financat lokale; miratimi i buxhetit; përcaktimin e tatimeve; kërkesa për hua; administrimi me pasurit e komunës; rrugët; institucionet për mbrojtje sociale dhe ndërmarrjet publike; kompetenca të gjera në fushën ekonomike, duke i’u dhënë ndihmë ndërmarrjeve publike komunat. Të hyrat më të mëdha vijnë nga donacionet e pushtetit qendror. Kemi dhe të hyrat lokale: për tokën e pandërtuar, hedhjen e bërðhokut, taksat për transport, nga depot, etj. Të hyrat për zhvillim formohen nga taksat për ndërtim dhe

rekonstruim, nga dënimet në komunikacion, nga pagesa në rrugë, ndihmë nga administrata e regjionit, departamentit apo pushteti qendror. Mbikqyrja e komunave ushtrohet nga pushteti qendror. Më 1982 bëhen reforma të reja për të rrit më shumë ingerencat e komunave dhe për të hap me shumë perspektivat e zhvillimit të komunës.⁷

⁷ Mersim Maksuti, E Drejta Kushtetuese, Strugë, 2024, fq. 403-417.

KAPITULLI II

TEORITË (BOTËKUPTIMET) PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

Ideja e vetëqeverisjes lokale është pjesë përbërëse e përpjekjeve njerëzore për demokratizimin e shoqërisë dhe për plotësimin efikas dhe cilësor të nevojave të qytetarëve. Raste të ndryshme socio-historike kushtëzuan qasje, shtrirje dhe kuptime të ndryshme të vetëqeverisjes lokale.

2.1 Teoria për të drejtat municipale

Sipas kësaj teorie, vetëqeverisja lokale është politikisht më e vjetër se pushteti qendror dhe shteti nuk mund t'i kufizojë të drejtat e saj, ashtu siç nuk guxon të kufizojë liritë dhe të drejtat personale të njeriut. Këto kuptime dolën në pah gjatë Revolucionit Francez të vitit 1789, i cili ishte gjithashtu një "lëvizje komunale". Pikëpamja se vetëqeverisja lokale është "më e vjetër" se shteti, ose së paku në rang të barabartë me të, doli në plan të parë në Kushtetutën e Belgjikës nga viti 1831 dhe ndikoi në sistemin belg të vetëqeverisjes lokale, si dhe në shtetet tjera evropiane.⁸

2.2 Shkolla historiko-juridike dhe vetëqeverisja lokale

Shkolla historiko-juridike është një grup teorish arkaiko-romantike për komunitetin lokal të mbrojtur nga historianët gjermanë të shekullit të 19-të, duke u kthyer dhe ëndërruar për "epokën e artë" të komuniteteve të vjetra familjare gjermane dhe duke mos marrë parasysh evolucionin e zhvillimit shoqëror. Në këtë kuptim, Gierke idealizoi disa forma të bashkësisë origjinale midis gjermanëve nëpërmjet komunitetit kooperativist (genossenschaft). Themeli i teorisë së tij është marrëdhënia Sozialrecht/Individualrecht. Ai ndërtoi një koncept të të drejtave të veta, origjinale të komuniteteve lokale. Në këtë kuptim duhet përmendur doktrina e së drejtës natyrore, në të cilën vendosen disa qasje themelore për përcaktimin e natyrës së vetëqeverisjes lokale. Të gjitha kuptimet tradicionale të komuniteteve lokale i gjejnë rrënjët në këtë doktrinë. Është zhvilluar kryesisht nga autorë francezë (A.Mabileau, P.Galès), por edhe nga autorë anglezë (D.Hill, R.Leach, J.Stewart). Sipas doktrinës, bëhet dallimi midis bashkësive lokale të krijuara "artificiale" që lindën si rezultat i një akti specifik të miratuar nga qeveria qendrore, komuniteteve administrativo-territoriale (si p.sh. kantone,

⁸ Гордана Силјановска-Давкова, Владимир Митков *et alia*, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 79.

rrethe, etj.) dhe entitete që linden "natyrshëm" që njihen nga autoritetet qendrore (për shembull, qytetet). Besohet se menaxhimi i këtyre subjekteve dominohet kryesisht nga interesat e shtetit, ndërsa subjektet vendore kanë të drejta të konsiderueshme autonome me interesat e tyre lokale.⁹

2.3 Teoria e *self-government*

Kjo teori është shumë pragmatike. Ajo përfaqëson dhe mbron pozicionin juridik të një fushëveprimi të veçantë vetëqeverisjes, e cila përfshinte “nga natyra” punët lokale dhe ishte në një gjendje ekuilibri me pushtetin qendror. Njerëzit kryesisht i bëjnë gjërat e tyre në komunitetin lokal dhe kur i tejkalojnë fuqitë e tyre, i transferojnë ato në komunitetin e gjerë. Teoria e vetëqeverisjes nuk e absolutizon as pushtetin qendror dhe as atë lokal. Ajo është kundër centralizmit, por edhe kundër decentralizimit të tepruar. Teoria nis nga kuptimi sociologjik i komunës si një komunitet real, si pjesë e trashëgimisë shoqërore dhe kulturore të konfirmuar historikisht të Anglisë. Dendias vuri në dukje rrezikun e identifikimit të komuniteteve lokale në faza të ndryshme të zhvillimit dhe beson se demokratizimi i përgjithshëm zvogëlon kundërshtimin mes vetëqeverisjes lokale dhe pushtetit qendror. Për teoricienin gjerman Preuss (Rugeuse), organet përfaqësuese lokale dhe qendrore janë në thelb i njëjti fenomen, sepse sistemi përfaqësues u zhvillua nga vetëqeverisja lokale në Angli, si dhe në Francë, Gjermani dhe Rusi. Por si më i vjetër bashkësia lokale ka përparësi ndaj qeverisë qendrore. Sipas Labband, bashkësitë lokale (korporatat) kanë të drejtë të menaxhojnë punët e tyre, por punët "e tyre" janë vetëm ato që nënkuptojnë kënaqësinë e interesave individuale. Gjithçka tjetër i përket pushtetit qendror. G. Jellinek (G. Jellinek)⁷⁹ bëri një kthesë vendimtare në kuptimin e dominimit të pushtetit qendror. Ai dallonte vetëqeverisjen aktive dhe pasive. Vetëqeverisja aktive ekzistonte kur pushteti qendror i jepte të drejta dhe detyra komunitetit lokal, i cili, nga ana tjetër, shprehte vullnetin e tij duke ushtruar të drejta subjektive. Vetëqeverisja pasive lindi kur shteti u jepte të drejta dhe detyra individëve, duke mos autorizuar dhe as detyruar komunitetin lokal. Me vetëqeverisjen pasive bëhet fjalë për realizimin e së drejtës objektive “me bashkëpunimin e bartësve të të drejtave dhe detyrave komunale”. Thelbi i kësaj teorie është se shteti mund të krijojë një korporatë (bashkësi) lokale që është relativisht e pavarur prej tij, ose të formojë organe lokale, pa status të pavarur.

⁹ Гордана Силјановска-Давкова, Владимир Митков et alia, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 80-81.

2.4 Teoria shtetërore e vetëqeverisjes lokale

Në shtetet anglo-saksone, teoria shtetërore e vetëqeverisjes lokale është kryesisht e ndërtuar dhe e bazuar në praktikën gjyqësore në lidhje me çështjet lokale. Sipas kësaj teorie, autoritetet lokale janë agjentët e parë dhe kryesorë të autoriteteve qendrore që synojnë të ofrojnë shërbime për popullatën në përputhje me standardet nacionale dhe nën kontrollin e shtetit. Funksioni kryesor i vetëqeverisjes lokale është ushtrimi i autoritetit publik në nivel lokal. Autoritetet lokale duhet të veprojnë vetëm kur shteti nuk është në gjendje të menaxhojë në mënyrë të pavarur të gjitha njësitë administrativo-territoriale nga pikëpamja teknike. Dhe disa autorë francezë si, për shembull, G. Mayon, P. Këtë teori e mbështesin edhe Duran (G. Majone, P. Duran). Pushtetet lokale janë themeluar kryesisht si mbështetje logjistike për pushtetin qendror, sepse sipas mendimit të këtyre autorëve, është e pamundur që shteti të menaxhojë me përpikshmëri gjithçka nga qendra pa krijuar autoritete lokale për të ndihmuar qeverinë qendrore. Studiuesi gjerman Rolf Grawert bazohet në mendimet e kolegëve të tij francezë dhe anglezë dhe beson se sa më shumë njësitë territoriale lokale të përfshihen në politikat shtetërore, aq më shumë detyrohen të abstrahojnë nga specifikat dhe problemet lokale dhe të marrin përsipër t'i ndjekin ato parimet e unifikuara të politikës shtetërore. Meqenëse pushtetet lokale janë të varura nga sistemi tatimor dhe financiar shtetëror, ato konsiderohen shumë më tepër si pjesë e shtetit sesa njësi territoriale të pavarura. Kjo është arsyeja pse aftësia e tyre për të bërë diçka në nivel lokal varet më shumë nga situata e përgjithshme në shtet sesa nga kushtet lokale.¹⁰

2.5 Teoria normativiste dhe administrata lokale

Hans Kelsen, si përfaqësues i teorisë normative, e barazoi administratën vendore me decentralizimin. Sipas tij, nëse bëhet fjalë për centralizim apo decentralizim varet nga vlefshmëria territoriale e normave, të cilat i referohen të gjithë territorit apo një pjese të tij. Kelsen foli për centralizimin total dhe vetëqeverisjen totale lokale si ekstreme, si dhe për vetëqeverisjen e përsosur dhe të papërsosur, në varësi të faktit nëse normat lokale janë përfundimtare, përfundimtare (kur shteti nuk mund t'i shfuqizojë, zëvendësojë ose përcaktojë përmbajtjen e tyre) ose të papërsosur (kur ai mund ta bëjë atë).¹¹

¹⁰ Гордана Силјановска-Давкова, Владимир Митков *et alia*, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 81-82.

¹¹ Ibidem., fq. 82.

2.6 Teoria e "qeverisjes lokale" versus "vetëqeverisja lokale"

Qeverisja lokale dhe vetëqeverisja lokale janë dy koncepte të ndryshme. Zakonisht në literaturë qeverisja lokale (e njohur më shpesh si “kontroll lokal”) përkufizohet si një grup autoritetesh lokale të emëruara nga qendra e shtetit të cilat *de jure* dhe *de facto* përfaqësojnë administratën shtetërore. Vetadministrimi lokal ose vetëqeverisja lokale organizohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur drejtpërdrejt nga popullata lokale, të cilët ushtrojnë kompetenca të përcaktuara me ligj. Duke pasur parasysh këtë dallim, është e nevojshme të mos ngatërrohet termi qeverisje lokale me termin vetëqeverisje lokale, sepse qeverisja lokale është një mekanizëm kompleks dhe fleksibël që përfshin si administratën publike lokale ashtu edhe organet përfaqësuese lokale.¹²

2.7 Teoria e *community development*

Teoria e "zhvillimit të komunitetit" u përcaktua nga Kombet e Bashkuara. “Zhvillimi i komunitetit nënkupton ato procese përmes të cilave aspiratat e vetë njerëzve janë të lidhura me përpjekjet e autoriteteve shtetërore për të përmirësuar kushtet ekonomike, sociale dhe kulturore të komuniteteve individuale dhe integrimin e tyre në jetën e kombit, për t'i mundësuar ata të nxisin përparimin e përgjithshëm”. Bëhet fjalë për një sërë veprimesh të planifikuara ekonomike, sociale dhe kulturore për zhvillimin e komunitetit lokal, për asistencën e jashtme ndaj nismave lokale. Qëllimet mund të jenë materiale (ndërtimi i tubacioneve të ujit), shëndeti (parandalimi i vdekshmërisë së fëmijëve), kulturor (zhdukja e analfabetizmit), etj. Në projektet e zhvillimit të komunitetit (duke nënkuptuar mbi të gjitha komunitetin lokal), katër elementë janë thelbësorë: një program i planifikuar, inkurajimi i vetë-ndihmës, asistencë teknike në formën e pajisjeve ose ekspertëve, ose të dyja. Iniciativat e nënkuptuara nën sintagmën "zhvillimi i komunitetit" synojnë të përshpejtojnë zhvillimin e zonave të pazhvilluara ku nuk ekzistojnë forca lokale të organizuara dhe kompetente. Iniciativa të tilla organizohen pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1959, 29 shtete morën ndihmë të këtij lloji. Qeveria e Indisë e konsideroi "zhvillimin e komunitetit" si metodën e vetme më të rëndësishme në dispozicion të saj për koordinimin e planifikimit social me atë ekonomik. Në Italinë jugore, po zhvillohet një luftë brenda komuniteteve lokale për të zhdukur analfabetizmin. Në Egjipt, "zhvillimi i komunitetit" nënkuptonte përmirësimin e mirëqenies rurale përmes vetëndihmës dhe pjesëmarrjes. Disa autorë nënvizojnë se

¹² Гордана Силјановска-Давкова, Владимир Митков *et alia*, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 83-84.

"zhvillimi i komunitetit" përfaqëson një përpjekje të organizuar nëpërmjet trajnimit dhe edukimit për të mundësuar pjesëmarrje më të gjerë individuale në zgjidhjen demokratike të problemeve të komunitetit. Rastet e teorisë së "zhvillimit të komunitetit" në praktikë kanë përfunduar me sukses ose dështim. Ajo tregon për faktin se vetë teoria nuk ka drejtime veprimi të përcaktuara mjaftueshëm shkencërisht, mjaft të përgjithshme për të mbuluar raste me përvoja të ndryshme. J. T. Sanders (J. T. Sanders) thotë se zhvillimi i komunitetit shihet si: një proces zhvillimi, një metodë, si një program dhe një lëvizje qëllimi i së cilës është mobilizimi i njerëzve bazuar në parimin e organizimit lokal. Megjithëse autorë të ndryshëm e përcaktojnë zhvillimin e komunitetit nga këndvështrime të ndryshme, të paktën në dy ose tre qasje hasim në idenë e pjesëmarrjes masive të njerëzve në përpjekjet e zhvillimit. Në fakt, bëhet fjalë për idenë e pjesëmarrjes.¹³

¹³ Гордана Силјановска-Давкова, Владимир Митков *et alia*, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 90-91.

KAPITULLI III

ASPEKTE JURIDIKO-KOMPARATIVE MBI VETËQEVERISJEN LOKALE

3.1 Vetëqeverisja lokale në Gjermani

Vetëqeverisja lokale në Gjermani është themelore për organizimin e administratës lokale, dhe si e tillë, është e organizuar në nivelet komunale, rajonale dhe qarkore. Këto nivele janë të përcaktuara nga ligjet nacionale të njësive konstitutive federale dhe janë pjesë e strukturës shtetërore. Në kontekstin gjerman të vetëqeverisjes lokale, një nga konceptet kyçe është "*Gemeinde*," që përkthehet si komunë ose bashki. Kjo është njësi themelore e administratës lokale dhe përfshin qytetet, fshatrat dhe zonat urbane. Këto komuna kanë autonomi të caktuar për të vendosur rregullat dhe politikat e tyre lokale. Në nivelin lokal, Këshilli Komunal (*Gemeinderat*) është organi zgjedhor që merr pjesë në vendimmarrjen dhe përcakton politikat. Kryetari i komunës (*Bürgermeister*) është një figurë kryesore e zgjedhur nga Këshilli Komunal dhe ka përgjegjësi menaxheriale administrative. Përtej kësaj, autoritetet lokale kanë përgjegjësi për plane zhvillimore, planifikim urban, arsimin, kulturën, dhe shërbimet e tjera publike. Financimi i tyre vjen pjesërisht nga taksat dhe tatimet lokal, duke siguruar autonomi financiare. Sidoqoftë, është e rëndësishme theksuar se struktura e vetëqeverisjes lokale mund të ndryshojë ndryshe në nivelet rajonale dhe qarkore, pasi përshtatet sipas nevojave specifike të secilit regjion. Në Gjermani, vetëqeverisja lokale është një sistem i ndarë në nivelet komunale, rajonale dhe qarkore, dhe ka disa karakteristika themelore: 1. Komuna (*Gemeinde*): Është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale dhe përfshin qytetet, fshatrat dhe rajonet urbane. Këtu, Këshilli Komunal (*Gemeinderat*) është organi zgjedhor kryesor dhe merr vendime lidhur me çështje lokale. Për më tepër, Këshilli Komunal (*Gemeinderat*): Këshilli zgjedhor komunal është organi kryesor i vendimmarrjes në nivel lokal. Ai ka detyrën e miratimit të buxhetit komunal, miratimit të politikave lokale dhe ndjekjen e zhvillimeve në komunë. Në këtë këshill përfshihen këshilltarët e zgjedhur nga qytetarët në zgjedhjet lokale. Kryetari i komunës (*Bürgermeister*) drejton administratën lokale. Me fjalë të tjera, Kryetari i Komunës (*Bürgermeister*) është drejtuesi i ekzekutivit lokal dhe zakonisht zgjidhet nga Këshilli Komunal. Kryetari ka përgjegjësi për administratën lokale dhe udhëheqjen e ekzekutivit. 2. Rajoni (*Landkreis*): Është njësi administrative më e lartë se komuna dhe ka përgjegjësi mbi disa komuna në një rajon. Rajonet janë të përfshira në organizatat më të mëdha si Këshillat e Qarkut (*Kreistag*) dhe Këshilltarët e Qarkut (*Landrat*). Ata kanë kompetenca mbi shërbimet rajonale, përfshirë transportin, arsimin e mesëm dhe

shëndetësinë publike. Në fakt, Këshillat e Qarkut (Kreistag) dhe Këshilltaret e Qarkut (Landrat): Në nivelet rajonale, këto këshilla dhe udhëheqësit e qarkut kanë përgjegjësi mbi shërbimet rajonale, përfshirë arsimin e lartë, transportin dhe shëndetësinë. 3. Qarku (Bundesland): Është një njësi administrative më e lartë dhe ka një nivel më të gjerë të autonomisë. Qarku është pjesë e sistemit federal gjerman dhe ka një qeveri të vetën. Qeveria e Qarkut (*Landesregierung*) drejtohet nga një kryeministër dhe ka përgjegjësi mbi sektorë të rëndësishëm si arsimi, shëndetësia, dhe ekonomia. Në nivelet qarkore, qeveritë e qarqeve kanë kompetenca më të gjera duke përfshirë legjislacionin e vet dhe menaxhimin e politikave për sektorë të ndryshëm. Ky sistem i shkallëve të ndërlidhura është pjesë e përpjekjeve për të siguruar që vendimmarrja dhe menaxhimi i çështjeve lokale të përshtaten me nevojat dhe karakteristikat e secilës komunitet. Sistemi gjerman i vetëqeverisjes lokale përdor parimin e subsidiaritetit, duke e lejuar shkallën më të ulët të qeverisjes të përgjigjet për sfidat konkrete dhe të marrë vendime sa më afër qytetarëve. Pra, në këtë mënyrë, vetëqeverisja lokale promovon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrjen, duke u bazuar në principin e subsidiaritetit, që favorizon zgjidhjet lokale për çështje të caktuara. Kjo strukturë e ndarë e vetëqeverisjes përmirëson qeverisjen demokratike dhe sjell efikasitet në menaxhimin e çështjeve lokale. Përveç kësaj strukture hierarkike, ka edhe mekanizma të tjera pjesëmarrjeje qytetare, si Këshillat Nacionale të qytetarëve dhe organizatat tjera civile, që kontribuojnë në dialogun dhe proceset vendimmarrëse lokale. Kjo transparencë dhe pjesëmarrje aktive e qytetarëve shërben për të siguruar se vendimmarrja lokale është e afërt me nevojat dhe preferencat e komunitetit. Në Gjermani, sistemi i vetëqeverisjes lokale është thelbësor për organizimin e jetës komunitare dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Në vijim, shpjegoj disa aspekte më gjerësisht: 1. Autonomia e Komunave: Komunitatet gëzojnë një grad të lartë të autonomisë dhe kanë përgjegjësi për të vendosur politikat dhe programet e tyre të veçanta. Kjo përfshin hartimin e planeve zhvillimore, menaxhimin e pronës komunale, dhe organizimin e shërbimeve lokale. 2. Financimi Lokal: Financimi i komunave vjen kryesisht nga taksat dhe tatimet lokale. Këto burime financimi u japin komunave një grad të konsiderueshëm të autonomisë financiare, duke mundësuar atyre të financojnë shërbimet dhe projektet lokale sipas nevojave të tyre specifike. 3. Bashkëpunimi Rajonal dhe Qarkor: Nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe qarkor, komunitatet mund të adresojnë sfida të përbashkëta dhe të koordinojnë veprimtari në fusha si transporti publik, mjedisi, dhe zhvillimi ekonomik. Këto shkëmbime koordinimi ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve. 4. Transparenca dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve: Gjermania ka një traditë të

fortë të transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Këshillat e Qytetarëve dhe audiencat publike janë mekanizma që inkurajojnë dialogun dhe konsultimin me komunitetin në vendimmarrje. 5. Mekanizmat e Demokracisë: Përveç zgjedhjeve lokale, ekzistojnë edhe mekanizma të tjera që promovojnë demokracinë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, përfshirë referendumet lokale dhe konsultimet publike për çështje të rëndësishme. Në esencë, sistemi i vetëqeverisjes lokale në Gjermani ndërthur autonominë, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve për të krijuar një ambient ku vendimmarrja lokale është e afërt me nevojat dhe vullnetin e komunitetit.¹⁴

3.2 Vetëqeverisja lokale në Francë

Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Francë është i organizuar nëpërmjet komunave, departamenteve dhe rajoneve. Komunitatet janë njësi themelore të vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë qytetet dhe fshatrat. Këto kanë këshillat komunale dhe një kryetar komune. Departamentet janë njësi administrative që mbulojnë një territor të caktuar dhe kanë një këshill departamenti dhe një prefekt, zyrtar qeveritar. Rajonet janë njësi më të mëdha se departamentet dhe kanë një këshill rajonal dhe një president rajonal. Sistemi i vetëqeverisjes lokale është i rëndësishëm për administratën vendore, duke ofruar autonomi dhe përgjegjësi në nivelet lokale të qeverisjes. Në Francë, këshillat komunale zgjidhen nga banorët dhe udhëhiqen nga kryetari i komunës. Këto këshilla merren me çështje të tilla si shëndetësia lokale, arsimi dhe infrastruktura. Ndërtojnë politika lokale dhe përgatisin buxhetin e tyre. Këshillat departamentale janë të përbërë nga anëtarët e zgjedhur nga qytetarët në secilin departament. Ata janë përgjegjës për shërbimet sociale, transportin dhe zhvillimin ekonomik të territorit të tyre. Rajonet janë njësi më të mëdha dhe kanë përgjegjësi për planifikim urban, zhvillim ekonomik dhe koordinim të shërbimeve të përbashkëta. Kryetari i rajonit dhe këshilli rajonal janë përgjegjës për drejtimin e politikave regionale. Ky model i shtrirjes së vetëqeverisjes lokale në Francë përbën një hierarki të qartë ku çdo nivel ka përgjegjësi specifike në menaxhimin e çështjeve lokale dhe administrative. Në thelb, sistemi i vetëqeverisjes lokale në Francë përbëhet nga tri nivele kryesore: komunitatet, departamentet dhe rajonet. Këto nivele janë autonome dhe kanë përgjegjësi të ndryshme në shërbime dhe

¹⁴ Shih: Local Government in Europe: The 'Fourth Level' in the EU Multilevel Policymaking System" Michael W. Bauer; The Oxford Handbook of Local and Regional Democracy in Europe, John Loughlin, Frank Hendriks, Anders Lidström; German Local Government in a Comparative Perspective", Hellmut Wollmann; Local Government and Public Service Reform Initiative; Local Government in the Member States of the European Union: A Comparative Legal Perspective, Christoph Moeller.

zhvillim lokal. - Komunat: Njësia themelore e vetëqeverisjes lokale, ku banorët zgjedhin këshillat komunale dhe kryetarin. Ata merren me çështje të përditshme lokale, duke përfshirë shëndetësinë, arsimin, dhe infrastrukturën. - Departamentet: Një nivel më i lartë, ku këshillat departamentale janë përgjegjëse për shërbimet sociale, transportin, dhe mbështetjen e zhvillimit lokal. Kryetari i departamentit dhe prefekti janë zyrtarë qeveritarë në këtë nivel. - Rajonet: Njësi më e lartë e vetëqeverisjes lokale, me këshillat rajonale dhe presidentin rajonal. Ata koordinojnë politikat e zhvillimit ekonomik, planifikimin urban, dhe shërbimet të cilat mund të përfshijnë disa departamente. Kjo strukturë e hierarkizuar e vetëqeverisjes lokale siguron që çdo nivel të ketë përgjegjësi të veta, duke promovuar decentralizimin dhe autonomi në administratën vendore. Në nivelin e komunave, kryetari dhe këshilli komunal janë përgjegjës për miratimin e politikave lokale, planifikimin urban, shërbimet shëndetësore dhe arsimore. Ata gjithashtu hartojnë buxhetin vjetor dhe mbikëqyrin zbatimin e projekteve lokale. Departamentet janë strukturat administrative që mbulojnë territor të gjerë dhe përfshijnë disa qytete dhe fshatra. Këshilli departamental ka përgjegjësi për shërbime sociale, transportin publik, edukimin e të rinjve dhe mbështetjen e familjeve. Rajonet, në nivelin më të lartë, kanë përgjegjësi për politikat e zhvillimit ekonomik regional, koordinimin e shërbimeve të përbashkëta, dhe planifikimin e territorit në nivel më të gjerë. Këshilli rajonal dhe presidenti rajonal luajnë rol kyç në hartimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillim të qëndrueshëm. Ky sistem i gjerë i vetëqeverisjes lokale në Francë inkurajon pjesëmarrjen aktive të banorëve dhe siguron që nevojat lokale të adresohen me efikasitet nëpërmjet një qeverisje të decentralizuar. Në nivelet e vetëqeverisjes lokale, qytetarët kanë një rol aktiv në demokracinë lokale. Ata zgjedhin përfaqësuesit e tyre në këshillat komunale, departamentale dhe rajonale, duke pjesëmarrë në procesin e vendimmarrjes lokale. Në komuna, kryetari dhe këshilli komunal kujdesen për nevojat e përditshme të banorëve, duke planifikuar infrastrukturë, duke menaxhuar shërbimet komunale dhe mbikëqyrur mirëqenien e përgjithshme të komunitetit. Departamentet, si një nivel mesatar, janë të përfshira në ofrimin e shërbimeve sociale dhe arsimore, ndërsa gjithashtu mbështesin projektet lokale të zhvillimit dhe integrojnë nevojat e të rinjve dhe familjeve. Rajonet, me përgjegjësitë e tyre më të gjerë, koordinojnë përpjekjet për zhvillim ekonomik, ruajtjen e mjedisit, dhe sigurojnë që politikat e tyre të reflektojnë diversitetin e nevojave në territorin e tyre të mbuluar. Në këtë mënyrë, sistemi i vetëqeverisjes lokale në Francë inkurajon pjesëmarrjen civile dhe siguron që vendimmarrja të reflektojë realitetin dhe prioritetet e komuniteteve lokale.

Një aspekt tjetër esencial në vetëqeverisjen lokale në Francë është koncepti i "decentralizimit." Ky koncept ka qenë një pikësynimi kryesor i reformave administrative në vend. Decentralizimi është përpjekur për të transferuar përgjegjësi dhe burime nga nivelet qendrore të qeverisjes drejt niveleve lokale. Kjo sjellje ka për qëllim lehtësimin e vendimmarrjes dhe lejon një aproksim më të afërt me nevojat dhe realitetet lokale. Decentralizimi ka rëndësi në forcimin e autonomisë së vetëqeverisjes lokale, duke mundësuar komunat, departamentet dhe rajonet të marrin vendime të pavarura dhe të krijojnë politika që përshtaten me kontekstin e tyre specifik. Ky model i dezentralizuar është një karakteristikë kryesore e sistemit të vetëqeverisjes lokale në Francë, duke synuar të sigurojë që vendimet dhe politikat të reflektojnë më mirë diversitetin dhe nevojat e komuniteteve lokale nëpër territorin e tyre. Një tjetër karakteristikë themelore e vetëqeverisjes lokale në Francë është roli i intensiv i pjesëmarrjes së publikut. Qytetarët kanë të drejtën dhe mundësinë të angazhohen në procesin vendimmarrës lokal përmes konsultimeve publike, audiencave, dhe formave të tjera të pjesëmarrjes. Pjesëmarrja aktive e publikut ndihmon në formimin e politikave lokale dhe vendimeve, duke siguruar që nevojat dhe preferencat e banorëve të reflektohen në procesin vendimmarrës. Kjo pjesëmarrje e gjerë promovon një qeverisje më transparente, demokratike dhe të përgjegjshme. Organizimi i konsultimeve publike dhe kanaleve të tjera të dialogut ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve lokale është një pjesë integrale e kulturës së vetëqeverisjes në Francë dhe kontribuon në rritjen e besimit dhe bashkëpunimit në nivel lokal.¹⁵

3.3 Vetëqeverisja lokale në Britaninë e Madhe

Në Britaninë e Madhe, vetëqeverisja lokale është themeluar nëpërmjet një strukture të ndarë në autoritete lokale. Këto përfshijnë këshilla komunalë dhe këshilla qarku. Këshilla komunalë janë të përgjegjshme për menaxhimin e çështjeve lokale, ndërsa këshillat e qarkut mbulojnë një territor më të gjerë dhe kanë përgjegjësi mbi çështje të tjera. Modeli i vetëqeverisjes lokale në Britani përfshin një kryetar komune dhe një këshillë komunal, të zgjedhur nga komuniteti lokal. Këto institucione kanë përgjegjësi në fusha si shëndetësia lokale, arsimi, planifikimi i zhvillimit urban, dhe shërbimet komunale. Është e rëndësishme të theksohet se sistemi i vetëqeverisjes lokale dallon apo ndryshon në pjesën e Anglisë, Skocisë,

¹⁵ Shih: Local Government in the United Kingdom, David Wilson; Local Government in the UK, Tony Byrne; The New British Politics, Ian Budge, David Robertson, Derek Hearl; Local Governance in Western Europe, Carlo Panara.

Uellsit dhe Irlandës së Veriut, pasi secili territor ka kompetenca të ndryshme dhe struktura specifike.¹⁶

Në Angli, për shembull, këshillat komunal janë të përgjegjshme për shërbime të tilla si mbrojtja civile, transporti lokal dhe zhvillimi ekonomik rajonal. Kryetari i Komunës dhe këshilli përbëhen nga përfaqësues të zgjedhur nga banorët. Në Skocinë, sistemi i vetëqeverisjes lokale ka një strukturë të ndarë, përfshirë këshilla komunalë dhe këshilla qarku. Skocia ka një gradë më të lartë autonomie në disa çështje, duke përfshirë arsimin dhe shëndetësinë. Në Uells, vetëqeverisja lokale është ndërtuar nëpërmjet Cymru a Councils, dhe ata kanë përgjegjësi për shërbime të ndryshme, duke përfshirë arsimin, transportin dhe planifikimin urban. Irlanda e Veriut ka një këshillë komunal dhe një këshillë qarku, dhe ata kanë kompetenca në fusha të tilla si edukimi dhe shëndetësia publike.¹⁷

Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Britaninë e Madhe është i ndarë në disa shkalla, duke përfshirë nivelin komunal dhe atë të qarkut. Ky model përbëhet nga: 1. Këshilla Komunalë: Këto janë autoritetet kryesore lokale dhe përgjegjëse për menaxhimin e shërbimeve dhe çështjeve lokale në një zonë të caktuar. Secila këshillë komunalë ka një kryetar komune dhe një këshill komunal të përzgjedhur nga banorët. 2. Këshillat e Qarkut: Ata janë në nivelin e lartë të vetëqeverisjes lokale dhe kanë përgjegjësi për çështje më të gjera rajonale. Këto këshilla janë përgjegjëse për koordinimin e disa shërbimeve dhe strategjive në një territor më të gjerë. Gjithashtu, sistemi i vetëqeverisjes lokale përfshin një lidhje të ngushtë me qeverinë qendrore, duke pasuar ligjet dhe politikat krah për krah me hartimin e tyre të politikave lokale. Kjo harmoni midis niveleve të ndryshme të vetëqeverisjes përmirëson koordinimin dhe përgjegjshmërinë në shërbimin ndaj qytetarëve. Një aspekt i rëndësishëm dhe tipik i vetëqeverisjes lokale në Britaninë e Madhe është bashkëpunimi dhe partneriteti mes autoriteteve lokale, sektorit privat dhe organizatave joqeveritare. Kjo përfshin ndarjen e informacionit, burimeve, dhe përfshirjen e palëve të ndryshme në procesin e vendimmarrjes. Për shembull, partneritetet lokale mund të përfshijnë një këshillë komunal që bashkëpunon me bizneset lokale për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik të zonës dhe për të siguruar vendet e punës. Ndërveprimi i ngushtë me shoqatat dhe organizatat komunitare gjithashtu është i rëndësishëm për të kuptuar më mirë nevojat dhe aspiratat e banorëve. Ky

¹⁶ Shih: Local Government in the United Kingdom, David Wilson; Local Government in the UK, Tony Byrne; The New British Politics, Ian Budge, David Robertson, Derek Hearl; Local Governance in Western Europe, Carlo Panara.

¹⁷ Ibidem.

përqaftim i partneritetit dhe bashkëpunimit është esencial për të përballuar sfidat komplekse dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës në nivel lokal.¹⁸

Në Britaninë e madhe shquhet transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve lokale ndaj qytetarëve. Kjo përfshin ofrimin e informacionit të përditshëm në lidhje me vendimmarrjen dhe shpenzimet publike. Transparenca lejon qytetarët të kenë një kuptim të qartë mbi mënyrën sesi funksionon vetëqeverisja lokale dhe sesa efektive janë shpenzimet e tyre. Për më tepër, mundësia për pjesëmarrje aktive në proceset e monitorimit dhe vlerësimit të veprimtarive lokale është esenciale për një sistemi të shëndetshëm vetëqeverisës. Ky nivel i transparencës dhe llogaridhënie siguron ndërtimin e besimit publik dhe përfshirjen e qytetarëve në kujdesin dhe përmirësimin e komunitetit të tyre.¹⁹

3.4 Vetëqeverisja lokale në Poloni

Në Poloni, vetëqeverisja lokale është e organizuar nëpërmjet një strukture të decentralizuar. Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Poloni ka disa shkalla ose nivele. Këto nivele përfshijnë: 1. Voivodeships (Provinca): Në total, ka 16 provincat në nivelin më të lartë të administratës lokale në Poloni. 2. Komunat: Komunat janë njësitë themelore të vetëqeverisjes lokale. Në nivelin e dytë, ka rreth 2470 komuna në Poloni. 3. Gminas: Komunat ndahen në njësi administrative më të vogla të quajtura "gminas." Gminas janë përgjegjëse për menaxhimin e çështjeve të përditshme lokale dhe janë një formë e organizimit të vetëqeverisjes lokale. 4. Sołectwos: Në nivelin më të ulët, gminas janë ndarë në njësi administrative më të vogla, të njohura si "sołectwos." Këto janë pjesë të vogla fshatrash ose zonash lokale. Kjo strukturë shumëshkallëshe e vetëqeverisjes lokale ka qenë thelbësore për decentralizimin dhe autonomine e niveleve të ndryshme administrative në Poloni.²⁰

Për më shumë, vlen të përmendet se komunat në Poloni janë të pavarësi normative brenda kornizës kushtetuese e ligjore, dhe si të tillë, kanë kryetarin e komunës dhe këshillin komunal, të zgjedhur nga qytetarët përmes zgjedhjeve demokratike lokale. Këta përfaqësues lokalë janë përgjegjës për vendimmarrjen në lidhje me shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë

¹⁸ Shih: Local Government in the United Kingdom, David Wilson; Local Government in the UK, Tony Byrne; The New British Politics, Ian Budge, David Robertson, Derek Hearl; Local Governance in Western Europe, Carlo Panara.

¹⁹ Ibidem.

²⁰ Shih: Shih: Local Government and Public Service Reform Initiative in Poland, Sławomir Zubrzycki; Decentralization in Poland, Anna Gwiazda; Local Governance in Central and Eastern Europe: Comparing Performance in the Czech Republic, Hungary, Poland, and Russia, Hellmut Wollmann.

me komunën, përfshirë buxhetin lokal, planifikimin urban, shërbimet sociale dhe shëndetësinë. Ekziston mundësia e krijimit të asociacionit kooperative mes komunave janë për të menaxhuar çështje lokale me interes të përbashkët. Kjo shpesh ndodh për të përmirësuar efikasitetin dhe koordinimin në shërbimet që përfshijnë më shumë se një komunë. Në një kontekst më të gjerë, këto nivele të vetëqeverisjes lokale shërbejnë për të përshtatur shërbimet dhe vendimmarrjen me realitetin lokal, duke siguruar një pjesëmarrje më aktive dhe një avansim të qëndrueshëm të komunitetit. Përforcimi i vetëqeverisjes lokale është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve lokale dhe për të reflektuar nevojat specifike të çdo komune. Qeveria qendrore e mbështet financiarisht vetëqeverisjen lokale, duke siguruar fonde për shërbimet dhe projektet lokale.²¹

Një aspekt tjetër është përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Rregulloret dhe ligjet e vetëqeverisjes lokale inkurajojnë organizimin e takimeve të hapura dhe konsultative për të dëgjuar pikëpamjet dhe nevojat e komunitetit. Ky theks në pjesëmarrje lokale shpie në një marrëdhënie të ngushtë mes autoriteteve lokale dhe qytetarëve. Gjithashtu, ky model i vetëqeverisjes lokale në Poloni ka pasuar një rrugë gradualisht drejt decentralizimit, duke i dhënë komunave më shumë autonomi dhe mundësi për të përshtatur shërbimet dhe zhvillimin e tyre sipas nevojave të tyre unike. Esenciale dhe më e rëndësishme në vetëqeverisjen lokale të Polonisë është përqendrimi në pavarësinë e komunave. Ky element lejon komunat të marrin vendime dhe të menaxhojnë shërbimet lokale në mënyrë autonome, duke përshtatur ato sipas nevojave specifike të komunitetit të tyre. Gjithashtu, theksimi në pjesëmarrjen e qytetarëve është një karakteristikë kryesore. Përmes takimeve të hapura dhe konsultative, qytetarët kanë mundësinë të ndikojnë në proceset vendimmarrëse dhe të shprehin nevojat e tyre. Kjo krijon një lidhje të fortë mes autoriteteve lokale dhe komunitetit, duke përmirësuar përputhjen e shërbimeve me pritjet dhe nevojat reale të qytetarëve. Në një kohë kur decentralizimi dhe autonomia lokale janë thelbësore, modeli i vetëqeverisjes lokale në Poloni ka ofruar një bazë solide për zhvillim dhe përmirësim të qëndrueshëm në nivelet lokale.²²

²¹ Shih: Local Government and Public Service Reform Initiative in Poland, Sławomir Zubrzycki; Decentralization in Poland, Anna Gwiazda; Local Governance in Central and Eastern Europe: Comparing Performance in the Czech Republic, Hungary, Poland, and Russia, Hellmut Wollmann.

²² Ibidem.

3.5 Vetëqeverisja lokale në Danimarkë

Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Danimarkë është i decentralizuar dhe shtrihet në tre nivele: 1. Komunat: Këto janë njësitë themelore të vetëqeverisjes lokale. Secila komunë ka një këshillë komunale dhe një kryetar komune, të zgjedhur nga qytetarët. Ata janë përgjegjës për shërbimet e përditshme, përfshirë arsimin, shëndetësin, dhe infrastrukturën lokale. 2. Regjionet: Pesë regjione (qarqe) kanë përgjegjësi për shërbimet më të mëdha dhe çështje regionale, duke përfshirë shëndetësin dhe zhvillimin ekonomik. Këto regjione koordinojnë bashkëpunimin midis komunave dhe sigurojnë implementimin e politikave regjionale. 3. Qeveria Qendrore: Përveç niveleve lokale, qeveria qendrore ka një rol në sigurimin e resurseve financiare dhe përcaktimin e disa politikave kryesore. Megjithatë, sistemi është i decentralizuar, duke lejuar komunat dhe regjionet të kenë autonomi dhe fleksibilitet në vendimmarrjen e tyre lokale. Ky model i shkallave të ndryshme të vetëqeverisjes është ndërthurur me një kulturë të theksuar të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, duke ndihmuar në formimin e politikave dhe planifikimin e zhvillimit lokal. Kjo shtrirje e shkallave ndihmon në adresimin e sfidave specifike të çdo komuniteti dhe rrit përgjegjësinë dhe llogaridhëninë në nivel lokal. Në nivelin lokal, Danimarka ka implementuar praktika të avancuara të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Këto praktika përfshijnë takime të rregullta publike, sondazhe lokale, dhe forume qytetare që inkurajojnë dialogun dhe bashkëpunimin. Përveç kësaj, politikat vendore shpesh synojnë promovimin e qytetarëve në procese të rëndësishme, duke siguruar se diversiteti dhe nevojat e komuniteteve të ndryshme janë reflektuar në vendimet lokale.²³

Karakteristikat, specifikat dhe rëndësia e vetëqeverisjes lokale në Danimarkë përfshijnë: 1. Autonomia Lokale: Komunat gëzojnë një gradë të lartë të autonomisë dhe vetëqeverisjes, duke pasuar modelin e "samstyres" ku ato kanë përgjegjësi për shumë aspekte të jetës lokale. 2. Pjesëmarrja e Qytetarëve: Përdorimi i praktikave inovative për të përfshirë qytetarët në proceset vendimmarrëse, duke zhvilluar konsultime publike, sondazhe, dhe forume qytetare. 3. Fokusi në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vëmendja ndaj politikave dhe projekteteve që promovojnë mjedisin e qëndrueshëm dhe zhvillimin ekonomik konzistent. 4. Bashkëpunimi dhe Partneriteti: Nxitja e bashkëpunimit midis sektorit publik,

²³ Shih: Local Government and Politics in Denmark, Poul Erik Mouritzen; Danish Local Government Reform: Lessons from a Decade of Policy Dynamics, Eva Sørensen; Nordic Administrative Reforms: Lessons for Public Management, Carsten Greve, Per Lægreid; Local Government in Denmark: From Welfare Administration to New Public Management, Lotte Bøgh Andersen, Timo Hener.

privat dhe shoqërisë civile për të arritur qëllimet e përbashkëta dhe për të adresuar sfidat lokale. 5. Inovacioni dhe Digitalizimi: Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar shërbimet, optimizuar proceset administrative dhe nxitur inovacionin social dhe ekonomik. 6. Menaxhimi i Krizave: Kapaciteti për të përgjigjur ndaj situatave emergjente dhe menaxhimi i krizave në mënyrë efikase, duke përfshirë plane të përgatitjes dhe reagimit në raste të ngjarjeve të papritura. 7. Nxitja e Zhvillimit Lokal dhe Solidaritetit: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe sigurimi i shpërndarjes së drejtë të burimeve midis komunave, pavarësisht nga madhësia dhe pasuria e tyre. Këto karakteristika e bëjnë veteqeverisjen lokale në Danimarkë një model të avancuar dhe fleksibël, i përshtatur me kërkesat dhe nevojat e komuniteteve lokale.²⁴

Një aspekt i rëndësishëm dhe i vlefshëm i veteqeverisjes lokale në Danimarkë është fokusi i tyre në mirëqenien dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët. Komunitetet punojnë në drejtim të sigurimit të shërbimeve të cilësisë së lartë, duke përfshirë shëndetësinë, arsimin, dhe kujdesin për të moshuarit. Nxitja e kulturës së shëndetshme dhe mjedisit të përshtatshëm jetësor, përmes infrastrukturës së qyteteve dhe hapësirave të zhvilluara publike, është thelbësore për të krijuar një mjedis të mbështetur për zhvillimin dhe kënaqësinë e banorëve. Kjo qëllim i përqendruar në mirëqenie ndikon pozitivisht në jetën e përditshme dhe përmirëson cilësinë e jetës së komunitetit lokal.²⁵

²⁴ Shih: Local Government and Politics in Denmark, Poul Erik Mouritzen; Danish Local Government Reform: Lessons from a Decade of Policy Dynamics, Eva Sørensen; Nordic Administrative Reforms: Lessons for Public Management, Carsten Greve, Per Lægreid; Local Government in Denmark: From Welfare Administration to New Public Management, Lotte Bøgh Andersen, Timo Hener.

²⁵ Ibidem.

KAPITULLI I IV

Vetëqeverisja lokale në të drejtën pozitive të Republikës së Maqedonisë së Veriut

4.1 Baza normative kushtetuese dhe ligjore e vetëqeverisjes lokale në RMV

Vetëqeverisja lokale zë një vend të rëndësishëm në Kushtetutën e RMV-së të vitit 1991, ku rradhite në një nga vlerat themelore të rendit kushtetues ekzistues.²⁶ Me këtë kushtetutë, të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut u garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale.²⁷ Me këtë, padyshim vetëqeverisja lokale merr status kushtetues dhe bëhet kategori kushtetuese në shtetin tonë. Në të njëjtën kohë në pjesën e V (neni 114, 115, 116, dhe 117) i vërteton karakteristikat përkatëse të vetëqeverisjes lokale:

- Qytetarëve u garantohet e drejta për vetëqeverisjes lokale;
- Themelimi në thelb i vetëqeverisjes lokale njëshkallëshe;
- Mundësia që njësit e vetëqeverisjes lokale të themelojnë forma të bashkësi vendore;
- Në njësit e vetëqeverisjes lokale qytetarët drejtpërdrejt dhe përmes përfaqësuesve marrin pjesë në vendosjen e çështjeve me interes lokal;
- Njësitve lokale u garantohet pavarësia në kryerjen e kompetencave të vërtetutara me Kushtetutë dhe me ligj. Kushtetuta e viti 1991 i thekson veçanërisht kompetencat në sferën e urbanizmit, veprimtaritë komunale, kulturën, sportin, mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, arsimimin parashkollor, arsimin fillor, mbrojtjen shëndetësore primare dhe sfera të tjera të garantuara me ligj.
- Njësitve të vetëqeverisjes lokale u garantohet financimi me burime vetanake të të hyrave të caktuara me ligj dhe me mjete nga Republika.

Sipas kësaj, duhet të kemi parasysh disa çështje:

- **E para, Kushtetuta e viti 1991 ua garanton të gjithë qytetarëve të drejtën për vetëqeverisje lokale .** E drejta për vetëqeverisje lokale është padyshi e drejtë politike që qytetarëve u mundëson të vendosin për çështjet nga sfera lokale në njësit e vetëqeverisjes lokale. Garantimi kushtetues i të drejtës së qytetarëve të vetëqeverisjes lokale e konfirmon karakteri demokratik i njësitve të vetëqeverisjes lokale.
- **E dyta, Kushtetuta e vitit 1991 themeloi vetëqeverisje lokale një shkallëshe.** Njësit e vetëqeverisjes lokale janë komunat. Kushtetuta parashef edhe një specifikë në sistemin e vetëqeverisjes lokale që mund të vërehet me pozitën juridike të qytetit të Shkupit si

²⁶ Kushtetuta e R. Maqedonisë së Veriut, Neni 8

²⁷ Kushtetuta e R. Maqedonisë së Veriut, Neni 114

njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, organizimi i së cilës rregullohet me ligj. Por, ky fakt me rëndësi nuk ndikoi në vetëqeverisjen lokale njëshkallëshe, për shkak se ndërmjet komunave, si njësi të vetëqeverisjes lokale, dhe qytetit të Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, sipas Kushtetutës, nuk egzistojnë raporte ndërmjet.²⁸

➤ **E treta, Kushtetuta e vitit 1991 përmban dispozitë sipas së cilës në njësit e vetëqeverisjes lokale mund të themelohen forma të vetëqeverisjes vendore.** Bëhet fjalë për lloje të njësive vendore dhe format të tjera të vetëqeverisjes vendore.

➤ **E katërta, nga një këndvështrim i pjesmarjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në njësit e vetëqeverisjes lokale, Kushtetuta e vitit 1991 parashef egzistimin vetëqeverisjes lokale të kombinuar të drejtpërdrejt dhe përfaqësuese.** Kjo nënkupton se qytetarët relizojnë të drejtën e vetëqeverisjes lokale drejtpërdrejt (me referendum dhe forma të tjera të vendimmarrjes së drejtpërdrejt) dhe përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike në organet e vetëqeverisjes lokale

➤ **E pesta, Kushtetuta e vitit 1991 siguron garanci se njësit lokale do gëzojnë pavarësi dhe mëvetësi në kryerjen e kompetencave të tyre burimore**

➤ **E gjashta, Kushtetuta këtë garanci e vendos edhe për pavarësinë financiare, gjegjësisht mundësin për financim të njësive të vetëqeverisjes lokale nga të hyrat vetanake (burimore).²⁹**

Me rëndësi është që kushtetuta që sa më qartë e rregulloja pozitën dhe rolin e vetëqeverisjes lokale në sistemin politik. Në këtë drejtim, Kushtetuta e vitit 1991 i përcakton parimet bazë dhe len hapësirë që vetëqeverisja lokale më detalisht të rregullohet me ligj/e. Ashtu, Kushtetuta e vitit 1991 shprehimisht parashef se:

- Vetëqeverisja lokale rregullohet me ligjin që sillet me shumicë të 2/3 të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve;
- Pozita territoriale e shtetit dhe zonat e komunës përcaktohet me ligj;
- Qyteti i Shkupit është njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, organizimi i së cilit rregullohet me ligj;³⁰

Vetëqeverisja lokale në Maqedoni gjatë viteve të 90 të shekullit XX ka egzistuar pa pavarësi financiare. Edhe gjatë analizës ligjore mund ta vërejmë se ka munguar edhe ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Të gjitha këto mungesa të kompetencave dhe sistemit joadekuat i financimit në këtë periudhë e ka vështirësuar gjendjen e komunave.

²⁸ Гордана Силјановска – Давкова, Владимир Митков *et alia*, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 262.

²⁹ Гордана Силјановска – Давкова, Владимир Митков *et alia*, Локална Самоуправа, Скопје, 2020, fq. 263.

³⁰ Ligji për qytetin e Shkupit (Gaz.zyrtare e RM, nr.49/1996)

Një përmbledhje, gjatë viteve të 90 të shekullit XX vetëqeverisja lokale e Maqedonisë është ballafaquar me mungesë të mjeteve financiare për qeverisjen lokale.

Si veçori të vetëqeverisjes lokale në Maqedoni gjatë viteve 90 të shekullit XX janë konsideruar, si vijon:

- Ndarja territoriale është bërë në bazë të kompromisit politik, dhe jo në bazë të konceptit që do respektojë të drejtën e qytetarëve në vetëqeverisjen lokale,
- Administrata komunale ka qenë e rekrutuar në pajtim me kriteriumet e partisë politike, dhe jo në bazë të profesionalizmit dhe dijes;
- Shfrytëzim i dobët i mekanizmave për vetëqeverisje lokale të drejtëpërdrejt nga qytetarët dhe pushtetet lokale;
- Komisione jofunksionale për marrëdhënie ndëretnike në njësit e vetëqeverisjes lokale;
- Rol i dobët i BNJVQ në kordinimin e interesave të njësivepër nevojat e njësive të bashkuar të qeverisjes lokale.³¹

Në këtë drejtim, edhe pse ndryshime të caktuara në këtë sferë filluar nga fundi i viteve të 90, megjithatë, procesi inklusiv i decentralizimit në maqedoni filloi si pasojë e nënshkrimit të marrëveshje kornizë të Ohrid. Pra, marrëveshja kornizë e Ohrid parashifte ndryshime konkrete të Ligjit për vetëqeverisje lokale me qëllim ritjen e kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale, sjelljen e ligjit të posaçëm për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, si dhe ndryshime në ligjin për organizimin territorial të shtetit.

Marrëveshja kornizë e Ohrid parashifte hapjen e procesit të decentralizimit të pushtetit. Nga gjithësejt 15 amandamente kushtetuese të votuara në vitin 2001 me qëllim implementimin e marrëveshjes kornizë të Ohrid, me 2 amandamente (Amandamenti XVI dhe XVII) i referohen vetëqeverisjes lokale.

Amandamenti XVI parashef që Ligji për vetëqeverisje lokale sillet me dy të tretat e shumicës, pas çka patjetër të ketë votat shumicë nga numri i përgjithshëm i deputetëve, që i takon komuniteteve që nuk janë shumicë në vendin tonë, përderisa, ligji për financimin, zgjedhjet lokale, kufitë komunale dhe qyteti i Shkupit, votohen me shumicë votash nga deputetët që janë prezent, pas çka patjetër të ketë shumicë votash nga deputetët prezent që i takojnë komunitetit që nuk janë shumicë në shtet.

³¹ Гордана Силјановска – Давкова, Владимир Митков, Тања Карамешева-Јовановска, Александар Спасеноски, Марко Кртолица, "Локална Самоуправа", Скопје, 2020, fq.266

Për dallim prej amandamentit XVI, që i referohet më shumë çështjes procedurale, Amandamenti XVII i referohet pikërisht procesit të decentralizimit dhe ritjes së kompetencave të njësive për vetëqeverisje lokale.

Pra, Amandamenti XVII e zavendësoi pikë 1 nga neni 115 i Kushtetutës ku parashihte se në njësit e vetëqeverisjes lokale qytetarët drejtpërdrejt dhe përmes përfaqësuesve marrin pjesë në vendimmarrjen e çështjeve me rëndësi lokale, posaçërisht në sferën e shërbimeve komunale, urbanizmin dhe planifikimin rural, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin ekonomik lokal, financimin lokal, veprimtarinë komunale, kulturën, sportin, mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, arsimin, mbrojtjen shëndetësore dhe sferat tjera të përcaktuara me ligj.

Me qëllim një pasqyrë sa më të qartë për rolin e Amandamentit XVII për ritjen e kompetencave, vijon tabelari për zgjidhjet nga Amandamenti XVII dhe gjendja para Amandamentit XVII të Kushtetutës së vitit 1991 për shqyrtim të kompetencave të njësive së vetëqeverisjes lokale:

Kompetencat	Neni 115 nga Kushtetuta e vitit 1991	Pika 1 nga amandamenti XVII i vitit 2001
1.Urbanizëm dhe planifikim hapësinor	X	X
2.Veprimtari komunale	X	X
3.Kulturë	X	X
4.Sport	X	X
5.Mbrojtje sociale dhe të fëmijëve	X	X
6.Arsimi parashkollor dhe fillor	X	X
7.Arsimi		X
8.Mbrojtjen shëndetësore		X
9.Shërbime publike		X
10.Mbrojtjen e hapësirës mjedisore		X
11.zhvillimin ekonomik lokal		X
12.Financimin lokal		X
13.Sfera tjera të		X

Burimi: Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov et alia, Локална Самоуправа”, Shkup, 2020, fq.269.

Ndërkaq, me Amandamentin e XVI të vitit 2001 për Kushtetutën e RMV-së përcaktohet se, qeverisja lokale rregullohet me ligj që miratohet me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç’rast duhet të ketë edhe shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojn komuniteteve joshumicë në RMV, ku siç shihet qëllimi i kushtetutvënësit është që, të mbrohet qeverisja lokale nga majorizimi etnik dhe voluntarizmi politik i ndërhyrjes së ligjvënësit në sferën lokale të qytetarëve. Me këtë ligj në mënyrë kualitative arrihen ndryshime në ndarjen vertikale të kompetencave në raport me ligjin mbi qeverisjen lokale të vitit 1995, duke u zgjeruar lista e kompetencave të organeve lokale. Dimenzioni funksional, administrativ dhe fiskal i decentralizimit duhet të forcojë qeverisjen lokale si balancë e pushtetit qendror, të thellojë demokracinë në nivel lokal, nga aspekti i interesit qytetarë dhe etnik, si dhe të sigurojë shërbime më të mira dhe më të shpejta në nivel lokal.³²

Sipas Ligjit mbi pushtetin lokal (2002) qytetarët realizojnë të drejtën e tyre në pushtet lokal në fushat sidomos të:urbanizmit, veprimtarive komunale, financave, arsimit, shëndetësinë, kulturës, sportit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve.

Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale duhet ti përmendim edhe dy specifika, edhe atë:

1. **E para, organizimi i qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale bëhet me ligj të veçantë (për qytetin e Shkupit është sjellur ligj i veçant)**
2. **E dyta, dispozitat e ligjit për Vetëqeverisje lokale vlejnë edhe për Qytetin e Shkupit vetëm nëse me Ligjin për Qytetin e Shkupit nuk parashifet ndryshe.³³**

Ligji për Vetëqeverisjet lokale i vitit 2002 (si dhe i vitit 1995) u garanton komunave subjektivitet juridik, ku në nenin 3 parashef se komunat janë persona juridik. Komuna ka territorin dhe emrin e saj të përcaktuar me ligj. Të gjitha njësit e vetqeverisjes lokale (komunat dhe qytetit i Shkupit) kanë statutin e vet. Statuti është akt juridik themeltar i njësive të vetëqeverisjes lokale.

³² Mersim Maksuti, “E drejta kushtetutese”, Tetovë, 2013, fq.293

³³ Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov, Tanja Karakamisheva-Jovanovska, Aleksandar Spasenovski, Marko Krtolica, “Локална Самоуправа”, Shkup, 2020, fq.272

4.2 Kryetari i Komunës

Kryetari paraqet organin individual egzekutiv të komunës me kompetenca të gjera dhe të rëndësishme, ku pozita e tij buron nga mënyra e drejtpërdrejtë e zgjedhjes së tij, sepse ai/ajo zgjedhet çdo katër vjet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Në këtë mënyrë edhe kryetari e fiton mandatin direkt prej qytetarëve, gjegjësisht votuesve, ashtu si edhe antarët e këshillit. Kryetari zgjidhet për mandat kohor prej katër vjetëve pa kufizim të rizgjedhjes. Në praktikën e deritanishme mund të vërehen shembuj ku personalitete të caktuar kanë qenë kryetar edhe tre apo katër mandate.

Për dallim prej antarëve të këshillit, pozita e Kryetarit kryhet profesionalisht. Nënkupton që për kohë sa e ushtron pozitën e Kryetarit nuk mund të ushtroj veprimtari tjera profesionale. Gjegjësisht ligji për vetëqeverisje lokale e rregullon edhe çështjen e konfliktit të interesit të kryetarit. Roli dhe rëndësia e kryetarit si organ egzekutiv individual e njësis së vetëqeverisjes lokale është e veçant për shkak të kompetenave të tij. Kryetari ka një numër të madh kompetencash, edhe atë:

- E përfaqson njësin e vetëqeverisjes lokale;
- Kontrollon ligjshmërinë e akteve të këshillit;
- I shpall aktet në buletin zyrtar të njësis së vetëqeverisjes lokale;
- Siguron zbatimin e vendimeve të këshillit;
- Siguron zbatimin e punëve që me ligjë i janë transferuar njësis së vetëqeverisjes lokale;
- Jep iniciativa dhe propozime deri te këshilli për sjelljen e akteve;
- Propozon buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit të njësis së vetëqeverisjes lokale;
- E realizon buxhetin;
- Zgjedh drejtorë në institucionet publike që i themelon njësi e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet konkursit publik;
- Rregullisht e njofton këshillin për kryerjen e kompetencave të veta në përputhje me statutin;
- Vendos në çështje administrative për të drejtat, obligimet dhe interesat e personave juridik dhe fizik, në përputhje me ligjin;
- Udhëheq me administratën komunale;

- Kryen punë të tjera të përcaktuar me ligj dhe me statut. Mund të autorizojë nëpunës udhëheqës të komunës që të udhëheq procedurën dhe të vendos për çështje administrative.³⁴

Gjatë numërimit të kompetencave të kryetarit mund të vërehet që kryetari organ egzekutiv ka kompetenca në mbrojtjen e kushtetutshmëris dhe ligjshmëris të njësisve të vetëqeverisjes lokale. Në këtë kontekst në qoft se kryetari konsideron ndonjë akt i caktuar i votuar nga këshilli i njësis së vetëqeverisjes lokale nuk është në pajtim me kushtetutën dhe ligjin, atëher ai është i obliguar në afat prej shtatë ditëve nga dita e votimit të aktit ta ndërpres shpalljen e së njëjtit. Në këto situata këshilli i njësis së vetëqeverisjes lokale është i obliguar ta shqyrtojë dhe të sjell vendim për aktvendimit në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes. Pastaj, këshilli mund ti pranojë arsyet e kryetarit dhe të vendos përsëri të mos e votoj aktin apo përsëri të tentoj ta përshtas me kushtetutën dhe ligjet, por gjithashtu mundet dhe të mos i pranojë arsyet e kryetarit dhe ta vërtetojë aktin e kontestuar. Në raste të mungesës apo pengesës, kryetari ka të drejtë të caktojë një antarë nga radhët e antarëve të këshillit të njësis së vetëqeverisjes lokale që do ta zëvendësojë. Për dallim nga Ligji për Vetëqeverisje lokale i vitit 1995, Ligji i vitit 2002 nuk parashikon mundësinë që qytetarët të inicojnë votëbesim të kryetarit të njësis së tyre të vetëqeverisjes lokale. Ligji ndalet vetëm te kushtet për ndërprerje dhe marjen e mandatit. Ashtu që, mandati i kryetarit mund të ndërpritet edhe para përfundimit të mandatit të tij katërvjeçar, nëse:³⁵

- Vetë jep dorëheqje nga pozita e Kryetarit;
- Si pasojë e vdekjes;
- Dënohet me aktgjykim të plotëfuqishëm për vepra penale me dënim burgim mbi gjashtë muaj;
- Me aktvendim të plotëfuqishëm i meret aftësia vepruese;
- Ndodh jokompatibilitet të funksionit kryetar;
- Mungon më shumë se gjashtë muaj, ndërsa këshilli me shumicë të dy të tretave konstaton se mungesa është e pa arsyeshme;
- Ndalon së qenuri banor i njësis së vetëqeverisjes lokale.³⁶

³⁴ Душица Перишиќ, Ардита Дема-мемети, Виктор Арнаудоскиа, Весна Арсовска- Динковска, Ивана Серафимова, Александар Арсовски, Илмиасан Даути, Прирачник за Градоначалниците и Советниците, за надлежностите на локалната самоуправа, 2017, Fq.28

³⁵ Neni 54, pika 1 nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gaz.zyrtare e RM" nr5/2002)

³⁶ Душица Перишиќ, Ардита Дема-мемети, Виктор Арнаудоскиа, Весна Арсовска- Динковска, Ивана Серафимова, Александар Арсовски, Илмиасан Даути, Прирачник за Градоначалниците и Советниците, за надлежностите на локалната самоуправа, 2017, Fq.29

Mandati i kryetarit, gjithashtu, mund edhe ti meret në raste të mungesës së paarsyeshme më shumë se gjashtë muaj. Për arsyeshmërin e mungesës vendos këshilli i njësisë së vetëqeverisjes lokale edhe atë me shumicë të 2/3 të antarëve të këshillit.

4.3 Këshilli i Komunës

Këshilli i Komunës është organi më i lartë në kuadër të komunës, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës përkatëse. Mandati i antarëve të këshillit komunal është katër (4) vjet. Nga numri i banorëve në një komunë varet edhe numri i antarëve në këshillin komunal. Raporti i numrit të banorëve dhe numrit të këshilltarëve në komuna paraqitet në tabelën e radhës:

Numri i banorëve	Numri i antarëve në këshill
Deri 5.000	9
Prej 5.001 deri në 10.000	11
Prej 10.001 deri në 20.000	15
Prej 20.001 deri në 40.000	19
Prej 40.001 deri në 60.000	23
Prej 60.001 deri në 80.000	27
Prej 80.001 deri në 100.000	31
Prej 100.000	33
Qyteti i Shkupit	45

Burimi: Ligji për vetëqeverisjes lokale (2002) neni 34

Antarët e Këshillit janë të autorizuar t'i përfaqsojnë qytetarët, dhe në interesin e tyre, e me bindje personale, të marrin vendime në Këshill. Këshilli punon në seanca dhe merr vendime në pajtim me kompetencat e veta:

1. Miraton Statutin e komunës dhe akte tjera që parashohin rregullat e punës;
2. Miraton buxhetin e komunës dhe bilancin vjetor të komunës;
3. Vendos për lartësinë e burimeve vetanake të të ardhurave për financimin e komunës;
4. Themelon shërbime publike komunale (ndërmarrje/institucione) dhe mbikqyr punën e tyre;
5. Emëron antarë në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike të cilat i themelon;
6. Miraton programe pune dhe plane financiare;
7. Miraton raportet financiare për realizimin e buxhetit dhe bilancin vjetor të komunës;

- 8.Miraton raportet e punës dhe bilancet vjetore të ndërmarrjeve publike që ka themeluar komuna;
- 9.Vendos për pronën në pronësi të komunës(qiradhënie, shitje);
- 10.Kryen kontroll financiar të buxhetit të komunës;
- 11.Zgjedh personin që udhëheq me njësinë rajonale të Ministrisë së Punëve të brendshme në komunë;
- 12.Shqyrton dhe miraton planin vjetor për siguri publike në territorin e komunës;
- 13.Të tjera.³⁷

Tash më e theksuam se antarët e këshillit të njësis së vetëqeverisjes lokale zgjidhen në zgjidhje të drejtëpërdrejta me mandat prej katër vjetëve. Pas vërtetimit të rezultateve dhe përfundimit të procesit zgjedhor hapi i parë i këshilltarëve të sapozgjedhur është konstituimi formal i këshillit. Kjo çështje është e rregulluar me nenin 37 të Ligjit për vetëqeverisje lokale e vitit 2002. Domethënë, Ligji për vetëqeverisje lokale i vitit 2002 parashikon se kryetari i këshillit nga përbërja paraprake në afat prej 20 ditëve nga dita e përfundimit të zgjedhjeve duhet ta thir seancën e parë të këshillit të ri të njësis së vetëqeverisjes lokale. Nëse këshilli i njësis së vetëqeverisjes lokale nuk thirret në afat prej 20 ditëve, atëher vetë këshilltarët në afat prej 10 ditëve, pas përfundimit të afatit paraprak, mblidhen nën kryesimin e antarit më të vjetër. Në seancën konstituive përveç vërtetimit të mandatit të antarëve të sapozgjedhur të këshillit të njësis së vetëqeverisjes lokale, gjithashtu, po vazhdohet edhe drejt zgjedhjes së kryetarit të këshillit. Kryetari zgjidhet nga rradhët e antarëve të këshillit, me mandat katër vjeçar.³⁸

Kandidati i cili do të fitoj shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i antarëve të këshillit(shumicë absolute) konsiderohet si i zgjedhur për kryetar i këshillit të njësis së vetëqeverisjes lokale.

Kryetari i këshillit i ka këto obligime:

- I thërret dhe udhëheq me seancat e këshillit;
- Kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit;
- I nënshkruan dispozitat që i ka sjellur këshilli dhe në afat prej tre ditësh nga dita e sjelljes ia dorëzon kryetarit për publikim.

³⁷ Nina Shulloviç-Cvetkovska, Admir Shabani, Maja Llazarova, Dushko Todorovski, Ljupka Guguçevska-Filiposka, "Doracak për zgjedhje lokale i dedikuar për votues", Shkup, 2021, Fq.10

³⁸ Neni 47, nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gaz.zyrtare RM", nr.5/2002)

Këshilli i komunës punon në seanca (më së paku një gjatë tre muajve), ndërsa ato i thir dhe udhëheq kryetari i këshillit. Gjatë thirjes me vetë iniciativë, kryetari i këshillit në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit është i obliguar të thir seancë të këshillit me kërkes të kryetarit apo edhe me kërkes të më së paku $\frac{1}{4}$ e antarëve të këshillit.³⁹ Dita, vendi dhe ora e mbajtjes së seancës së këshillit, si dhe propozimi për rendin e ditës në të cilën do punohet në këshill detyrimisht të shpallet më së paku shtatë ditë para mbajtjes së seancës. Antarët e këshillit të njësis së vetëqeverisjes lokale në realizimin e funksionit të tyre kanë një numër të drejtash dhe obligimesh, që rregullohen me nenin 43 nga Ligji për vetëqeverisjes lokale. Atëherë, antarët e këshillit kanë të drejtë dhe detyrim të jenë prezent dhe të marrin pjesë në punën e këshillit dhe trupat tjerë punuese. Anëtarët kanë të drejtë në seancat e këshillit të japin iniciativa dhe propozime dhe t'i parashtrojnë pyetje kryetarit. Anëtari i këshillit nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shfaqur ose për votim në këshill. Punëdhënësi është i detyruar ta lirojë nga puna profesionale antarin e këshillit për të marrë pjesë në seancat e këshillit ose komisionet ku ai është antar. Përveç të drejtave dhe obligimeve të theksuara antarët e këshillit kanë edhe të drejta dhe obligime tjera të përcaktuara me statutin dhe dispozitat tjera.

Mandati i antarit të këshillit mund të ndërpritet edhe para kohe, edhe atë në disa raste:

- Jep dorëheqje;
- Në rast të vdekjes;
- Nëse është i dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për vepër penale të dënueshme me dënim burgim prej mbi gjashtë muajsh;
- Nëse ndodh jocompatibilitet me funksionin antarë i këshillit në pajtim me ligjin;
- Nëse i meret aftësia vepruese me aktvendim të plotëfuqishëm;
- Nëse ndalon së qenuri banor i njësis së vetëqeverisjes lokale.⁴⁰

³⁹ Neni 39, paragrafi 2, nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gaz.zyrtare RM", nr.5/2002)

⁴⁰ Душица Перишиќ, Ардита Дема-мемети, Виктор Арнаудоскиа, Весна Арсовска- Динковска, Ивана Серафимова, Александар Арсовски, Илмиасан Даути, Прирачник за Градоначалниците и Советниците, за надлежностите на локалната самоуправа, 2017, Fq.26

4.4 Organizimi i administratës komunale

Për kryerjen e punëve nga kompetenca e organeve të komunës i organizon administrata komunale puna e së cilës është publike. Organizimi, fushëveprimi, mënyrën e kryerjes së punëve caktohet në këshillin komunal me propozim të kryetarit të komunës. Ligji për Vetëqeverisje lokale nga viti 2002, në kapitullin e VI e rregullon administratën e njësive të vetëqeverisjes lokale (administrata komunale). Ashtu, në fillim në këtë kapitull definohet se administrata komunale i kryen punët nga kompetenca e vetëqeverisjes lokale. Sipas kësaj, duhet të kemi parasysh se administrata komunale paraqet shtyllë të funksionimit të njësive të vetëqeverisjes lokale për shkak se është e detyruar për:

- Përgaditjen e akteve për këshillin dhe kryetarin;
- Përgaditjen e seancave të këshillit, si dhe seancat e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
- Kryerjen e punëve profesionale për këshillin dhe kryetarin;
- Drejtimin e kontabilitetit/llogaridhënien të njësive për vetëqeverisjen lokale;
- Ndjekjen e problematikës për sferën nga kompetenca e njësive të vetëqeverisjes lokale, kryerjen e analizave të gjendjes dhe jep iniciativa apo propozime për zgjedhjen e tyre;
- Dhënie të informatave dhe të dhënave në lidhje me aktivitetet e njësive të vetëqeverisjes lokale me kërkes të organeve kompetente apo në bazë të ligjit;
- Menaxhimin me dokumentet e njësive të vetëqeverisjes lokale si dhe ruajtjen deri te shkatërimi, gjegjësisht deri te dorëzimi te arkiva shtetërore;
- Kryerjen e punëve tjera që i përcakton këshilli dhe kryetari.⁴¹

Nga e gjithë kjo e sipërtheksuara, mund të vijmë në përfundim se administrata komunale ka rol të madh në zbatimin praktik të politikave lokale të sjellura nga organet e vetëqeverisjes lokale. Në këtë drejtim, me qëllim për kontroll më të madh dhe mbikqyrje, ligji për vetëqeverisje lokale u mundëson njësive të vetëqeverisjes lokale mundësi për organizimin e inspektoratit komunal për kryerjen e mbikqyrjes inspektuese mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e saj. Nëpunësit në administratën komunale janë pjesë e administratës publike, të punësuar me kontratë të përhershme. Ato nuk zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe nuk duhet të zavendësoen pas zgjedhje së kryetarit të ri/kryetares së re të komunës ose këshillit.

⁴¹ Gordana Siljanovska – Davkova, Vladimir Mitkov et alia, Локална Самоуправа, Shkup, 2020, fq. 321.

Ajo çka është me rëndësi është se gjatë punësimit në administratën komunale dhe ndërmarjet publike që i themelon komuna duhet të ketë kujdes për përfaqsimin adekuat të gjitha komunitetëve. Administrata komunale organizohet në sektore dhe departamente. Sektori punon për bashkimin në mes veti të sa më shumë reparteve nga kompetenca e komunës apo për avancimin e bashkëpunimit të departamenteve në përbërjen e tij (inspektorati komunal, sektori për përkrahjen e kryetarit, sektori për zhvillimin ekonomik lokal, për financat dhe tjera), ndërsa departamentet obligohen për kryerjen e punëve tjera të njejtë lloj, që kryhen në organet e komunës (juridike- normativ, menaxhimin me resurset njerëzore etj). Me Ligjin për vetëqeverisje lokale të vitit 2002 rregullohet edhe statusi i të punësuarve në administratën komunale. Në të njejtën kohë, ligji për vetëqeverisje lokale i vitit 2002 i ndan të punësuarit në administratën komunale në dy grupe. Në grupin e parë i klasifikon të punësuarit në administratën që kryejn punë profesionale, normative- juridike, mbikqyrëse-administrative, dhe zgjedhin punë administrative duke potencuar se këta të punësuar kanë statusin e shërbyesve shtetëror dhe se për ato vlen ligji për shërbyesit administrativ. Nga ana tjetër, ligji për vetëqeverisjes lokale në grupën tjetër i vendos të punësuarit që kryejn punë administrative teknike i dhe punët ndihmëse dhe parashef se për ato vlen dispozitat nga legjislacioni i punëve. Megjithatë, reformat në administratën publike në vitet e fundit sollën që Ligjin për shërbyesit shtetëror të shfuqizohet, ndërsa statusi i të punësuarve në administratën komunale të rregullohet me ligjin për shërbyesit administrativ në vitin 2014.⁴² Në mënyrë plotësuese në vitin 2014 u votua edhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, i cili gjithashtu përmban dispozita për të punësuarit në administratën komunale.

4.5 Mbikëqyrja mbi punën e komunave

Shteti për shkak të Kushtetutshmëris dhe Ligjshmëris si dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarit siguron mbikqyrjen mbi punën dhe aktet e njësive të vetëqeverisjes lokale. Mbikqyrja mbi punën e komunave paraqet çështje që gjithmonë fiton vëmendje të veçantë për vetëqeverisjen lokale. Shpesh ndodh që pikërisht përmes mbikqyrjes institucionet qendrore të fitojnë mundësi e kufizimit të funksionimit të vetëqeverisjes lokale. Prandaj edhe Karta Evropiane për vetëqeverisjes lokale e përshkruan se kryerja e mbikqyrjes mbi punën e vetëqeverisjes lokale duhet të kryet përmes dispozitave ligjore koncize.

⁴² Ligji për shërbyesit administrativ ("Gaz zyrtare e RM nr.27/2014)

Në Ligjin për Vetëqeverisje lokale të vitit 2002 në kapitullin e IX parashikohet mbikqyrja mbi punën e organeve të vetëqeverisjes lokale. Ky kapitull përbëhet prej 5 neneve (69,70,71,72,73), të cilat qartazi e përcaktojnë karakterin e mbikqyrjes mbi punën e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Për çka nevojitet mbikqyrja mbi punën e pushtetit lokal?

1. Transferi i një numri më i madh i kompetencave në nivel lokal, nënkupton përgjegjësi më të madhe të pushtetit lokal ndaj qytetarëve.
2. Egzekutimi i kompetencave nga ana e pushtetit lokal duhet të jetë komplementare, gjegjësisht në pajtim me prioritetet nacionale, në drejtim të cilësisë së nevojave publike dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve.
3. Në punën e pushteti lokal duhet të sigurohet respektimi i ligjeve, respektimi i procedurave të shkruara dhe ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë gjatë sjelljes së akteve.⁴³

4.6 Llojet e mbikqyrjeve

Mbikqyrja dhe kontrolli në kryerjen e kompetencave në vetëqeverisjen lokale kryhet me zbatimin e disa llojeve të mbikqyrjes:

Lloji i mbikqyrjes	Kompetent për zbatim të mbikqyrjes
Mbikqyrja mbi ligjshmërinë e akteve	Ministria e vetëqeverisjes lokale, përmes inspektoratit shtetëror për vetëqeverisje lokale
Mbikqyrje inspektuese mbi procedurën për sjelljen e akteve	Inspektorati shtetëror për vetëqeverisje lokale
Mbikqyrja mbi ligjshmërinë dhe efikasitetin e punëve të organeve të komunës	Organet e administratës shtetërore kompetent për ndjekjen e ligjeve nga kompetenca e tyre
Mbikqyrja mbi ligjshmërinë e punës së organeve të komunës për kryerjen e kompetencave të deleguara	Organet e administratës shtetërore kompetenca e së cilës janë të deleguara komunës
Mbikqyrja mbi punën materialo financiare të komunës	Ministria e financave dhe organet e saj

⁴³ Маја Лазаравоа, Нина Шуловиќ, Кристина Јованова, Илија Стоилев, Прирачник за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2018, fq.22

Mbikqyrja inspektuese mbi zbatimin e ligjeve	Organet inspektuese
---	----------------------------

Sipas ligji për mbikqyrje inspektuese, që e rregullon procedurën për kryerje të mbikqyrjes inspektuese, mbikqyrjen inspektuese e kryen inspektori, përmes:

- **Mbikqyrja inspektuese e rregullt** është mbikqyrje e paralajmëruar që kryhet në bazë të programës për punë të shërbimeve inspektuese dhe përfshin mbikqyrje mbi zbatimin e ligjeve dhe akteve të votuar mbi bazën e ligjeve. Inspektorat shtetëror për vetëqeverisje lokale e kryen mbikqyrjen inspektuese të rregullt përmes shqyrtimit dhe kontrollit të vendimeve të këshillit komunal, që shpallen në buletin komunal.

- **Mbikqyrja inspektuese e jashtëzakonshme** është mbikqyrje e paparalajmëruar dhe kryhet mbi bazën e iniciativën e parashtruar nga organet shtetërore, persona fizik apo juridik, si dhe në raste në dyshimit të inspektorit – sipas detyrës zyrtare.

- **Mbikqyrja e kontrolli inspektues** po kryhet pas skadimit të afatit të caktuar në aktin inspektues sjellur nga ana e inspektorit, pas çka inspektori gjatë përcaktimit të gjendjes faktike mund të konstatoj se subjekti plotësisht ka vepruar pas aktit inspektues, pjesërisht ka vepruar ose nuk ka vepruar pas aktit inspektues. Mos veprimi, gjegjësisht veprimi pjesërisht pas aktit inspektues paraqet bazë për zbatimin e masave inspektuese në pajtim me Ligjin.⁴⁴

Kjo kornizë ligjore e mbikqyrjes mbi punën e vetëqeverisjes lokale qysh në fillim parashef varshmëri të karakterit të mbikqyrjes mbi llojin e kompetencës ndaj njësive të vetëqeverisjes lokale. Prandaj, kur bëhet fjalë për kompetenca burimore të mbikqyrjes së punëve të njësive të vetëqeverisjes lokale, nënkupton:

- Ligjshmërinë;
- Kontroll dhe revizion mbi punën materialo finansiare të njësive të vetëqeverisjes lokale

⁴⁴ Маја Лазарова, Нина Шуловиќ, Кристина Јованова, Илија Стоилев, Прирачник за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2018, Fq.24

4.7 Mbikëqyrja e ligjshmërisë të akteve normative juridike të komunës

Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e akteve të njësive të vetëqeverisjes lokale e kryen ministria kompetente për kryerjen e punëve të vetëqeverisjes lokale (Ministria për vetëqeverisje lokale)⁴⁵. Domethënë, kryetari i njësis së vetëqeverisjes lokale është i obliguar në afat prej 10 ditëve nga dita e shpalljes së akteve të njejtat ti dorëzoj në ministrin përkatëse për kryerjen e punëve nga vetëqeverisja lokale. Në qoftë se ministria përkatëse konsideron se akti nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, atëher në afat prej 45 ditëve nga dita e dërgimit të aktit duhet të sjell aktvendim për ndërprerje për zbatim të aktit. Përveç kontrollit të ligjshmërisë të akteve të organeve të vetëqeverisjes lokale, gjithashtu duhet të kemi parasysh se mbikëqyrja mbi ligjshmërinë së punës së organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale kryejn edhe organet e pushtetit qendror. Sa i përket punës materialo financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale kontrollin e kryen Ministria e Financave,⁴⁶ përderisa Enti Shtetëror i Revizionit është i obliguar për revizion mbi punën materialo financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale⁴⁷. Në këtë drejtim, kryetari është i obliguar në afat prej 30 ditëve nga dita e sjelljes, të dorëzoj raportet për egzekutimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të njësis së vetëqeverisjes lokale deri te Enti Shtetëror për Revizion.

4.8 Mbrojtja juridike kushtetuese e vetëqeverisjes lokale

Për pozitën juridike dhe rolin e vërtet të vetëqeverisjes lokale në sistemin politik nuk është e mjaftueshme të garantohet vetëm me Kushtetutë. Me atë që qytetarëve u garantohet me Kushtetutë e drejta e vetëqeverisjes lokale nuk dmth se do të realizohet. Në fakt, realizimi i vetëqeverisjes lokale mund të sigurohet vetëm atëher kur qytetarëve dhe njësive të vetëqeverisjes lokale do tu sigurohet mjetet juridike dhe të tjera instrumente për mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale në rast shkeljes apo kufizimit të kësaj të drejte. Nëse nuk është e siguar mbrojtja e vetëqeverisjes lokale, atëher ky institucion mund të jetë vetëm deklarative. Në këtë kontekst Ligji për vetëqeverisje lokale garanton tre parime bazë të realizimit të së drejtës së vetëqeverisjes lokale. Sipas parimit të parë, këshilli i vetëqeverisjes lokale, si dhe kryetari, mundet para Gjykatës kushtetuese të parashtrojë kërkes për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjeve, si dhe kushtetutshmërin dhe ligjshmërinë e akteve të përgjithshme të ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore me të cilat shkelet

⁴⁵ Neni 70, Pika 1, Ligji për vetëqeverisje lokale (Gaz.zyrtare e R.M nr.05/2002)

⁴⁶ Neni 70, Pika 3, Ligji për vetëqeverisje lokale (Gaz.zyrtare e R.M nr.05/2002)

⁴⁷ Neni 70, Pika 4, Ligji për vetëqeverisje lokale (Gaz.zyrtare e R.M nr.05/2002)

pozita kushtetuese dhe të drejtat e njësive të vetëqeverisjes lokale të garantuara me ligj dhe Kushtetutë.⁴⁸ Sipas parimit të dytë, njësive të vetëqeverisjes lokale u garanohej mbrojtje juridike para gjykatave kompetente në kontekst të akteve dhe aktiviteteve të organeve të administratës shtetërore dhe Qeverisë së Republikës me të cilat u pengohet kryerja e kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale që u janë të dhëna me Kushtetutë.⁴⁹ Në fund, sipas parimit të tretë, njësit e vetëqeverisjes lokale në kohë dhe përkatësisht të jenë të konsultuar për procedurën dhe vendimarrjen për çështje që u përkasin atyre.⁵⁰ Për më tepër njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet të konsultohen e për planifikimin për punët publike para përgaditje të planit për planifikim hapësinor të Republikës. Në botën bashkëkohore, në aspektin teorik vlerësohet se ka më shumë shtete, në të cilat vetëqeverisja lokale bartet në plan të dytë në raport me shtetin dhe pushtetin shtetëror, i cili e merr mbi vete rregullimin e disa çështjeve të rëndësishme për ekzistencën e qytetarëve. Arsytet janë të ndryshme, por si më të rëndësishme theksohen: Zgjerimi i rolit të shtetit bashkëkohor, forcimi i centralizmit dhe etatizmit. Formimi i shumë partive politike, të cilat nuk shfaqin interesim për politikën lokale. Kalimi i shumë punëve, të cilat më parë kryheshin nga ana e pushtetit vendor në kompetenca të pushtetit shtetëror. Ngushtimi i pavarësisë financiare të vetëqeverisjes lokale, e cila varësohet nga donacionet dhe subvencionet e shtetit. Ngushtimi i pavarësisë së vetëqeverisjes lokale nga aspekti normativ. Zvogëlimi i hapësirës së vetëqeverisjes lokale për nevojat e punëve publike të veçanta (shëndetësia, arsimi, komunikacioni etj.).⁵¹ Këto janë disa veti të shteteve ku vetëqeverisja lokale ka mbështetje të vogël, por nga ana tjetër, ekziston taborri i shteteve ku vetëqeverisja lokale ka një rëndësi të veçantë. Aty bëhet fjalë për një vetëqeverisje lokale demokratike. Përveç dispozitave kushtetuese, funksionimi i vetëqeverisjes lokale zhvillohet në kornizën ligjore që përmban disa ligje: Ligji për vetëqeverisjen lokale (që konsiderohet “kushtetuta e vetëqeverisjes lokale”), Ligji për qytetin e Shkupit, Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, Ligji për bashkëpunimin e ndërsjellë, Ligjin për organizimin territorial të Vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me Ligjin për Vetëqeverisjen lokale (Gaz zyrtare e RM nr.5/2002) rregullohet çështja e kompetencave të komunave (listë e kompetencave), pjesmarja e drejtëpërdrejt e qytetarëve në vendimarrje (iniciativa qytetare, tubime të qytetarëve, referendum), organizmin dhe punën e organeve të komunës (këshilli dhe

⁴⁸ Neni 87, Ligji për vetëqeverisje lokale (Gaz.zyrtare e R.M nr.05/2002)

⁴⁹ Neni 88, Ligji për vetëqeverisje lokale (Gaz.zyrtare e R.M nr.05/2002)

⁵⁰ Neni 78, Ligji për vetëqeverisje lokale (Gaz.zyrtare e R.M nr.05/2002)

⁵¹ Agni Aliu, Esat Stavileci, “Qeverisja lokale”, Tetovë-Prishtinë, 2009, fq.36

kryetari), administrata e komunës (organizimi i saj dhe punët që i kryen), aktet që i sjell këshilli dhe kryetari, pronën e komunës, mbikqyrjen mbi organet e komunës (mbikqyrjen mbi ligjshmërin dhe kontrollin dhe revizionin mbi punën materialo financiare), shpërndarjen e këshillit të komunës, mekanizmat për bashkëpunim ndërmjet organeve të komunës dhe qeverinë, mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale, përcaktimi i gjuhës zyrtare dhe çështje tjera nga rëndësia e vetëqeverisjes lokale. Megjithatë, edhe pse ligji është votuar para njëzet vjetëve, deri më sot aspak nuk është ndryshuar apo plotësuar. Kjo mund të arsyetohet me atë përshkak nevojës së shumicës së dyfishtë (për plotësim apo ndryshim). Komunitatet çështjen e kompetencave e rregullon me statutin dhe aktet tjera.

4.9 Transparenca në punën e komunave në rafshin lokal

Transparenca në komuna është parimi bazë i komunikimit me qytetarët dhe vendimmarrjes së një komune. Realizimi i parimit të transparencës dhe qasjes së qytetarëve në komuna, nënkupton obligimin e të gjitha komunave, që ndaj qytetarëve dhe palëve tjera të interesuara të bëjnë transparente dhe të qasshme aktivitetet e tyre. Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja në një demokraci moderne duhet të mundësojnë që reflektimet e jashtme të merren parasysh gjatë zgjidhjes së problemeve komplekse në shoqëri sepse transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e bën sistemin kushtetues dhe politik të një vendi më demokratik dhe gjithëpërfshirës. Demokracia i referohet qeverisjes/menaxhimit në të cilën qytetarë të ritur fuqin dhe përgjegjësinë qytetare i realizojnë drejtëpërdrejt apo tërthorazi përmes përfqsuesve të tyre të zgjedhur.

- Demokracia është themeli i parimit të qeverisjes së shumicës, që nënkupton se vendimet që sillen nga shumica duhet të pranohen nga të gjithë, por patjetër të respektohen edhe qëndrimet e pakicës.
- Në shoqëritë demokratike pushteti qendror caktohet për decentralizim të pushtetit në nivel lokal, duke kuptuar që problemet lokale më suksesshëm po kryhen lokalisht.
- Demokratët zbatojnë rregullisht, zgjedhe fer, të lira për të gjithë qytetarët me të drejtë vote
- Në shoqëritë demokratike qytetarët kanë të drejtë dhe përgjegjësi të marrin pjesë në jetën politike

- Në shoqëritë demokratike respektohen vlerat e tolerancës, bashkëpunimit dhe kompromisit.⁵²

Obligimet që dalin nga Ligji për vetëqeverisjen lokale janë për informimin e rregullt të publikut nga ana e organeve të komunës (kryeari dhe këshillit), komisionet e këshillit dhe shërbimet publike të themeluar nga komuna, për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë për zhvillimin e komunës. Gjithashtu, njësit e vetëqeverisjes lokale janë të detyruar që qytetarëve t’iu mundëson qasje deri te informatat bazike për shërbimet që u’a siguron.

Gjithashtu, Ligji për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik e vërteton obligimin e organeve dhe institucionet e sektorit publik për shpallje publike të të dhënave që i krijojnë gjatë realizimit të kompetencave të tyre në pajtim me ligjin, me qëllim që të mundësojnë shfrytëzimin e atyre të dhënave nga ana e personave fizik dhe juridik për krijimin e informatave të reja, përmbajtjen, aplikimet ose shërbimet, edhe atë në format të informata të hapura në pajtim me mundësit teknike të institucionet.

Shqyrtimet e informatave që duhet të publikohen në web-faqet, si dhe në forma të dhëna të hapura është bërë bazë të kompetencave ligjore të njësive të vetëqeverisjes lokale, si dhe nga obligimet që dalin nga ligjet e veçuara të krijojnë informata, përmes udhëheqjes regjistrave dhe evidencës. Në të njëjtën kohë është marrë parasysh dhe interes i qytetarëve organizatave për marrjen e informatave të caktuar dhe të dhëna që janë veçanërisht të rëndësishme për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies për inkuadrimin e tyre në proceset e krijimit të politikave në nivel lokal, si dhe informatat për të cilën qytetarët konsiderojn se ashtu do u’a lehtësojnë qasjen deri te shërbimet publike. Gjithashtu, janë të mbuluar edhe informatat /të dhënat për të cilën interes tregojnë komuniteti- biznesit, veçanërisht për shpalljen e tyre në formatin e hapur, me qëllim shfrytëzimin e tyre për krijimin e aplikacionin e dobishëm për qytetarët dhe për zhvillimin e komunitetit lokal, duke bërë realizimin vlerë të shtuar ekonomike në shoqëri. Qëllimi përfundimtar është, përmes aplikimit të standardeve për e-transparencë në të gjitha njësit e vetëqeverisjes lokale, të sigurohet shpallje e barabartë e informatave të parashikuara dhe të dhënave të dobishme për komunitetin e biznesit. Pas shembullit të praktikave të mira të shteteve-anëtare të Unionit Evropian, implementimin e standardeve për e-transparencë duhet të sigurohet udhëheqje

⁵² Маја Лазарова, Нина Шуловиќ, Кристина Јованова, Илија Стоилев, Прирачник за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2018, fq.36

transparente dhe llogaridhënese në nivel lokal dhe të stimulohet pjesmarrja qytetarëve.⁵³ Dokumenti është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin informatat të cilat duhe të publikohen në web-faqen e njësis së vetëqeverisjes lokale, të ndara në fusha, me periudhë të caktuar kohore për përmbajtje të përditësuar dhe të vërtetuar. Pjesa e dytë i përfshin ato informata/të dhëna që mund të publikohen në format të të dhënave të hapura. Informatat dhe të dhënat që shpallen rekomandohet që të publikohen ndaras në gjini, atje ku është e mundshme.

Shqyrtimi i informatave nga sfera për publikimin e web-faqeve të NJVQ:

Financat publike

Shpenzimet në vlerë mbi 30.000,00 denarë, që përfshinë:

- Pagesën e faturave;
- Pagesën e shërbimeve dhe produkteve të prokuruar;
- Grantet e dhuruar;
- Kostot e përgjithshme;
- Qiramarrja;
- Detyrimet kreditore;
- Transaksione ndaj institucionet tjera

Për çdo shpenzim të bërë në vlerë mbi 30.000,00 denarë, NJVQ i publikon të dhënat e rradhës:

- Datën e kryerjes së shpenzimit/pagesës;
- Personi fizik/juridik ndaj të cilit është kryer pagesa;
- Vlera e shpenzimit në denarë;
- Baza e shpenzimit

Përditësimi: Mujorë⁵⁴

Informatat nga furnizimet publike

Publikohet plani vjetor për furnizime publike me të dhënat si vijon:

- Numri rendor i procedurës;
- Lënda e kontratës për furnizimet publike/ marrëveshje kornizë;
- Shifra nga FPPF (fjalorthi i përgjithshëm i furnizimeve publike);
- Nisja e procedurës (muaji kur do të publikohet shpallja);
- Vlera e parashikuar e kontratës/marrëveshjes kornizë;

⁵³ Мартин Тодевски, Стандарди за е-транспаретност во единиците на локалната самоуправа, 2017, fq. 3

⁵⁴ Мартин Тодевски, Стандарди за е-транспаретност во единиците на локалната самоуправа, 2017, fq.4

Përditësimi: Sjelljen e planit vjetor për furnizime publike

Për çdo furnizim publik të shpallur, të shpallen të dhënat e rradhës:

- Numri i shpalljes;
- Lënda e kontratës për furnizimin publik;
- Vlera e parashikuar e kontratës (pa TVSH- denarë);
- Lloji i procedurës që do të shfrytëzohet;
- Kriteret për shpërndarjen e procedurës;
- Dokumentacioni tenderik;
- Afati për dorëzim të ofertës;
- Link deri te SEFP (sistemi elektronik i furnizimeve publike)

Përditësimi: Me shpalljen e furnizimit publik në SEFP⁵⁵

Për çdo kontratë të lidhur pas zbatimit të furnizimit publik, të shpallen të dhënat e rradhës;

- Numri i kontratës (numri arkivor i organit kontraktues);
- Lënda e kontratës;
- Numri dhe data e procedurës së zbatuar për furnizim publik;
- Emri i bartësit të kontratës me të cilin është lidhur kontrata;
- Vlera e kontratës (pa TVSH)

Përditësimi: Kuartal

Buxheti i NJVQ

Publikohet propozim buxheti i NJVQ dhe buxheti i miratuar i NJVQ në formë dhe strukturë konformë Ligjin për buxhet.

Përditësimi: Vjetor, pas përgaditjes së propozim- buxhetit, gjegjësisht pas miratimit të buxhetit.

NJVQ i publikon të gjitha rebalancet e miratuara të buxhetit.

Llogaria përfundimtare:

Publikohet menjëher pas miratimit të së njëjtës, në formë dhe strukturë konformë Ligjit për buxhet.

Përditësimi: Pas miratimit të së njëjtës.

Buxheti qytetar:

Publikohet në formë të buxhetit programor, menjëherë pas miratimit të buxhetit.

Përditësimi: Vjetore, pas miratimit të buxhetit.⁵⁶

⁵⁵ Ibid

4.9.1 Zbatimi dhe promovimi i parimeve të transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunal

Baza e transparencës dhe llogaridhënies në punën e këshillave komunale janë të parapara në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, dhe Ligjin për shfrytëzim të të dhënave nga sektori publik. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale seancat e këshillit janë publike. Për përjashtimin apo largimin e publikut në seancë vendoset vetëm nëse egzistojnë arsye të justifikuara të vërtetuara me Statutin e komunës. Për shpalljen e seancës të mbyllur votohet me shumicë të dyfishtë vota nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve. Sipas Ligjit për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik poseduesit e informatave me karakter publik janë komunat dhe organet e komunave, të qytetit të Shkupi dhe komunat në qytetin e Shkupit. Me informatë me karakter publik nënkupton informata në çfarëdo forme që e ka krijuar dhe me të cilën disponon poseduesi i informatës, gjegjësisht me të disponon vetëm poseduesi i informatës në pajtim me kompetencat e tij. Me Ligjin për shfrytëzim të të dhënave nga sektori publik vërtetohet detyrimi i organeve dhe institucioneve nga sektori publik për shpallje publike të të dhënave që i krijojnë në realizimin e kompetencave të tyre, në pajtim me ligjin. Qëllimi është me shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik, të stimulohet, në mes tjerash, përfshirja sociale dhe ritja e llogaridhënies dhe transparencës e sektorit publik. Parimet e udhëheqjes demokratike kërkojnë që qytetarët dhe qytetaret vazhdimisht të jenë të informuar dhe të konsultuar përzbatimin e programeve që janë të një rëndësie të madhe për përmirësimin e kushteve për jetë në komunitetin e tyre lokal. Për shkallën e realizimit të programeve të premtuar qytetarët dhe qytetaret patjetër të jenë të informuar në kohë për shkak të rritjes së besimit në punën e pushtetit lokal, që paraqet investim për marrjen e përkrahjes në periudhat tjera. Transparenca nënkupton rrjedhje të lirë të informatave një njësin e vetëqeverisjes lokale. Bartësit e funksioneve publike janë të obliguar të ndajnë dhe të kërkojnë informata kthesë në lidhje me të gjitha aktivitetet që kontribuojnë në ndryshime në mirëqenien e komunitetit. Nevojitet transparenca në shpalljen në kohë të informatave për aktivitetet e planifikuara, vendimet e marra dhe hapat e realizuar.

⁵⁶ Мартин Тодевски, Стандарди за е-транспаретност во единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2017, fq.5

Transparenca nënkupton shpalljen në kohë të informatave për aktivitetet e planifikuara, vendimet e marra dhe hapat e realizuar.⁵⁷

Vetë pushteti lokal është e detyruar të gjejë formën më të mirë për informim të publikut. Mënyrat e informimit të qytetarëve mund të jenë të ndryshme- përmes tabelave të njoftimit, takime publike, gazeta, radio, televizion, internet, etj. Mvarësisht nga struktura e popullatës në pjesë të ndara të komunës, duhet të gjindet metoda më e mirë se si informata të arrij te qytetarët. Në raste të caktuar komuna do të shfrytëzoj mediumet elektronike si mjet për komunikim, por në raste tjera – për shkak nivelit të ulët të qytetarëve që kanë qasje në internet, ky kanal mund të tregohet si jo i duhur.

Qytetarët kanë të drejtë të dinë si pushtetet i zbatojnë premtimet të dhëna gjatë kohës së kampanjës zgjedhore, çfarë vendime meren, cilat vendime nuk zbatohen dhe pse nuk zbatohen dhe në çfarë sasive realizohen projektet vjetore. Pushtetet lokale duhet ti konsultojnë qytetarët edhe gjatë fazës së vendosjes së prioriteteve në lidhje me shfrytëzimin e resurseve publike, për të kënaqur nevojat publike i një numri të madh qytetarësh. Këtë detyrim njëkohësisht e ka kryetari dhe antarët e këshillit.

Publiku ka të drejtë të dijë si harxhoen resurset publike dhe me mendimet e veta dhe rekomandimet të kontribuojë për menaxhim sa më të mirë.

Më konkretisht, transparenca në punën e këshillit nënkupton:

- Publikimin në kohë të informatave për mbajtjen e seancës së Këshillit
- Publikimin në kohë rendin e ditës
- Publikimin e procesverbalit nga seanca e mbajtur;
- Transmetimin live të seancave të Këshillit
- Prezenca në Këshill të qytetarëve të interesuar
- Konsultim me qytetarët para sjelljes së vendimeve të caktuara të Këshillit dhe⁵⁸
- Tjera

Transparenca dhe llogaridhënia si parime të udhëheqjes demokratike janë dy faqe të tregimit e cila quhet qasje e lirë e informatave nga komunat dhe institucionet publike në nivel lokal ndaj qytetarëve dhe e kundërta. Shqyrtim i informatave nga sfera për shpallje në web-faqen e NJVQ.

⁵⁷ Маја Лазаравоа, Нина Шуловиќ, Кристина Јованова, Илија Стоилев, Прирачник за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2018, fq. 39.

⁵⁸ Маја Лазаравоа, Нина Шуловиќ, Кристина Јованова, Илија Стоилев, Прирачник за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2018, fq. 40.

Statuti i NJVQ.

Shpallet Statuti i NJVQ.

Përditësimi: Nëse ndodh ndryshime.

Antarët e Këshillit.

Publikohen të dhënat për të gjithë antarët e NJVQ, edhe atë për çdo antarë:

- Emri dhe mbiemri;
- Fotografia;
- Përkatësia etnike;
- Gjinia;
- Niveli arsimimit;
- Përkatësia partiake;
- E-mail;
- Telefon kontakt

Përditësimi: Pas çdo ndryshimi.

Rregullorja për punën e këshillit.

NJVQ e publikon Rregulloren për punën e këshillit

Seancat e këshillit

Publikohen informatat për të gjitha seancat e këshillit të NJVQ, në shqyrtim të përmban më së paku:

- Vitin;
- Numrin;
- Datën;
- E rregullt/E jashtëzakonshme;
- Rendin e ditës;
- Procesverbal nga seanca e mbajtur.

Përditësimi: Pas çdo seance të mbajtur

NJVQ publikon njoftim për seancë në të njëjtën kohë me caktimin e saj, me informata për numrin e seancës, datën e mbajtjes dhe rendin e ditës të seancës.

NJVQ publikon procesverbalet nga seancat e mbajtura.

NJVQ publikon formular për paraqitje për pjesmarrje në seancën për palët e interesuar.

Komisionet/Trupa e Këshillit

Publikohen informata për të gjitha trupat e këshillit, me shqyrtim që më sa paku përmban të dhënat e radhës:⁵⁹

- Emri i komisionit/trupit;
- Emri dhe mbiemir;
- Funksioni (kryetar/antarë);
- E-mail;
- Telefon kontakti.

Përditësimi: Nëse ndodh ndryshim.

NJVQ i publikon njoftim të seancave të komisioneve të Këshillit të njejtën kohë me caktimin e saj me informata për numrin e seancës, datën e mbajtjes dhe rendin e ditës.

NJVQ publikon procesverbale nga çdo seancë të mbajtur.

Buletini zyrtar

Publikohen të gjitha buletinet zyrtare të votuara nga Këshilli.

Publikohet shqyrtimi i buletineve zyrtare të votuara, i cili më së paku përmban:

- Viti;
- Numri;
- Data;
- Linku deri te buletini zyrtar.

Përditësimi: Pas shpalljes së buletinit zyrtar.

Dokumentet strategjike të miratuara

Publikohen të gjitha dokumentet strategjike të miratuara që janë votuar nga NJVQ . Për dokumentet strategjike të miratuara publikohet emri i dokumentit dhe sigurohet qasja elektronike deri te dokumenti.

Përditësimi: Pas çdo ndryshimi.

⁵⁹ Мартин Тодевски, Стандарди за е-транспаретност во единиците на локалната самоуправа, Скопје, 2017, fq.6

5. Konkluzione

Në Maqedoninë e Veriut, struktura dhe modeli i vetëqeverisjes lokale është i organizuar nëpërmjet komunave. Komunat janë njësitë themelore të vetëqeverisjes lokale dhe kanë këshillin komunal si organin kryesor vendimmarrës. Ky këshill përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga qytetarët në zgjedhjet lokale. Kryetari i këshillit komunal është udhëheqësi kryesor i komunës dhe është i përgjegjshëm për drejtimin e përgjithshëm të punës së këshillit. Në nivelin ekzekutiv, ka një kryetar komune që udhëheq administratën lokale dhe implementon vendimet e këshillit.

Konkluzionet për vetëqeverisjen lokale në Maqedoninë e Veriut mund të jenë:

1. Progresi dhe Sfīdat: Maqedonia e Veriut ka bërë progres në zhvillimin e vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë krijimin e strukturave dhe kompetencave lokale. Megjithatë, ka sfida në fusha si pjesëmarrja e qytetarëve dhe financat lokale.

2. Rëndësia e Transparencës dhe Llogaridhënies: Në kontekstin e kërkesave për përgjegjshmëri dhe transparencë, autoritetet lokale duhet të thellojnë angazhimin e tyre për të siguruar që proceset vendimmarrëse janë të hapura dhe të llogaridhënshme.

3. Ndërveprimi Ndërkombëtar dhe Zhvillimi Lokal: Ndhima ndërkombëtare dhe partneritetet me organizatat ndërkombëtare mund të jenë burime të rëndësishme për të ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe realizimin e projekteve zhvillimore.

4. Inovacioni dhe Teknologjia: Përdorimi i teknologjisë dhe inovacioni mund të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, duke sjellë përparime në lidhje me administratën dhe mundësuar trajtimin e efektshëm të informacionit.

5. Nevoja për Strategji Afatgjata: Qeverisja lokale duhet të zhvillojë strategji afatgjata që adresojnë sfīdat komplekse të zhvillimit urban, mirëqenies sociale, dhe ruajtjes së mjedisit, duke siguruar që ky zhvillim është i qëndrueshëm.

6. Roli i Qytetarëve si Partnerë: Pjesëmarrja e qytetarëve duhet të rritet duke i përfshirë ata si partnerë aktivë në vendimmarrje dhe duke zhvilluar mekanizma efektivë të konsultimeve publike. Për të siguruar një vetëqeverisje lokale të suksesshme, ka nevojë për përkushtim të vazhdueshëm për përmirësim, bashkëpunim efektiv dhe pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha palët përfshirëse.

7. Përmirësimi i Klimës Biznesore Lokale: Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për bizneset lokale, përfshirë lehtësimin e procedurave administrative dhe ofrimin e stimuljeve për investime, do të nxitë zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës.

14. Ruajtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore: Përmbajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore lokale duhet të jetë një pikë e rëndësishme në strategjitë e vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë përkrahjen e ngjarjeve kulturore dhe investime në infrastrukturën kulturore.

15. Adaptimi Ndaj Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike: Qeverisja lokale duhet të hartojë plane dhe masa për të adresuar sfidat e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së mjedisit dhe promovimin e praktikave mjedisore.

16. Inkluziviteti dhe Përfaqësimi i Përfaqësuesve të Minoriteteve: Sigurimi i përfaqësimit të barabartë dhe pjesëmarrjes së përgjithshme të komuniteteve të minoriteteve në proceset vendimmarrëse lokale është jetik për një vetëqeverisje të drejtë dhe inkluzive.

17. Monitorimi i Drejtësisë Sociale: Përmirësimi i aksesit të barabartë të shërbimeve sociale dhe monitorimi i drejtësisë sociale në nivel lokal duhet të jenë një fokus për të siguruar mirëqenie dhe përfshirje për të gjithë qytetarët.

18. Ndërtimi i Ndërgjegjësimit Qytetar: Kampanjat për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me detyrat dhe rolin e tyre në zhvillimin lokal janë të rëndësishme për të krijuar një shoqëri aktive dhe përgjegjshme. Në përfundim, për të arritur një vetëqeverisje lokale të suksesshme, është e nevojshme të përqendrohen përkushtim, bashkëpunim, dhe inovacion në të gjitha nivelet e administratës lokale për të përmbushur nevojat dhe pritjet e qytetarëve në një mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

19. Përmirësimi i Edukimit dhe Kulturës Qytetare: Nxitja e projekteve edukative dhe kulturore që promovojnë identitetin lokal, duke përfshirë iniciativa për rritjen e lexueshmërisë dhe aftësimeve të kreativitetit.

20. Përdorimi i Modelit të Zhvillimit të Hulumtimeve Lokale: Hulumtimi lokal dhe analizat e nevojave të komunitetit mund të ofrojnë udhëzime të rëndësishme për formulimin e politikave dhe projektet që pasqyrojnë realitetin e vendit.

21. Rritja e Sigurisë Urbane: Plani për sigurinë e qytetit dhe masat e zbatueshme për të ulur kriminalitetin dhe rritur ndjenjën e sigurisë për banorët duhet të kujdeset si një prioritet i përhershëm.

22. Nxitja e Ekonomisë Sociale dhe Solidare: Përkrahja e iniciativave të ekonomisë sociale, duke përfshirë krijimin e kooperativave dhe ndihmën për bizneset sociale, mund të ndihmojë në zvogëlimin e privimit ekonomik dhe përmirësimin e përfshirjes sociale.

23. Përdorimi i Burimeve Natyrore me Kujdes: Administrata lokale duhet të zhvillojë plane për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke përfshirë menaxhimin e ujërave, mbrojtjen e mjedisit, dhe përdorimin e energjisë së qëndrueshme.

24. Sfidat e Migracionit dhe Diversitetit Kulturor: Ndërkombëtarizimi dhe migracioni mund të sjellin sfida dhe mundësi të reja për vetëqeverisjen lokale, duke përfshirë menaxhimin e diversitetit kulturor dhe përkujdesjen për nevojat e komuniteteve të ardhshme.

25. Rritja e Tolerancës dhe Dialogut të Përbashkët: Nxitja e dialogut të hapur dhe tolerancës mes komuniteteve të ndryshme është jetike për krijimin e një mjedisi harmonik dhe përballimin e sfidave të tensioneve sociale. Këto aspekte shtohen për të thelluar në detaje sfidat dhe mundësitë që lidhen me vetëqeverisjen lokale në Maqedoninë e Veriut, duke reflektuar një përqsje më gjerë mbi zhvillimet dhe sfidat e komunitetit lokal.

BIBLIOGRAFIA

“Qeverisja Lokale”, Agni Aliu, Esat Stavileci, Tetovë-Prishtinë, 2009

“E Drejta Kushtetuese”, Mersim Maksuti, Tetovë, 2013

“Filles E Së Drejtës”, Naser Ademi, Tetovë. 2012

Гордана Силјановска – Давкова, Владимир Митков, Тања Каракамишева-Јовановска, Александар Спасеноски, Марко Кртелица, “Локална Самоуправа”, Скопје, 2020

Visar Morina, Florent Muçaj, Entela Nikaj, Jeton Shasivari dhe Luz Balaj, “Vetëqeverisja Lokale : Shqyrtime teorike dhe krahasimore”, Prishtinë, 2021

Ligji Për Vetëqeverisje Lokale

Ligji për Qytetin e Shkupit

Ligji për shërbyesit administrativ

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Прирачник за Градоначалниците и советниците за надлежностите на локалната самоуправа, Душица Перишиќ, Ардита Дема- Мехмети, Виктор Арнаудоски, Весна Арсовска- Динковска, Ивана Серафимова, Александар Арсовски, Илмиасан Даути, Скопје, 2017

Прирачник за промовирање на принципите на демократско управување во советите на единиците на локалната самоуправа Маја Лазарова, Нина Шуловиќ- Цветковска, Кристина Јованова, Илија Стоилев, Скопје ,2018 .

Стандарди за е-транспарентност во единица на локалната самоуправа- Мартин Тодевски Скопје, 2017.

<https://rm.coe.int/european-charter-of-local-self-government-eng/1680a87cc3>